

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI MASTER: PEDAGOGJI -DREJTIMI: TEORIK-SHKENCOR



**TEZA MASTER**

**Perceptimet e drejtorëve, mësime dhënë dhe të prindërve  
për organizimin e mësimit në distancë**

Mentori:

Prof. Dr. Demë Hoti

Kandidatja:

Mire Osmanaj Camaj

*Prishtinë, Shkurt 2022*

© [2022]-[Mire Osmanaj Camaj] Të gjitha të drejtat të rezervuara.

## ABSTRAKT

Në këtë punim paraqitet një pasqyrë e organizimit të mësimit në distancë, duke u dhënë zë përvojave dhe perceptimeve të drejtorëve, mësimitdhënësve dhe prindërve për organizimin e mësimit në distancë.

Mësimi në distancë si një formë e re e mësimnxënies, që realizohet përmes teknologjisë së komunikimit ka rezultuar me vlerë dhe në kohët e sotme ka gjetur përdorim shumë të madh. Gjatë elaborimit të këtij punimi kam paraqitur përkufizimet për mësimin në distancë, organizimin e mësimit në distancë si dhe perceptimet e akterëve më të rëndësishëm në procesin e mësimnxënies dhe mësimitdhënies siç janë drejtorët, mësimitdhënësit dhe prindërit.

Gjatë hulumtimit u përdorë metoda e përzier, ajo kualitative (cilësore) dhe kuantitative (sasiore) me qëllim të zbulimit të perceptimeve dhe qëndrimeve të drejtorëve e të mësimitdhënësve e po ashtu edhe të prindërve. Popullata për zgjedhjen e kampionit të këtij studimi ishin drejtorët, mësimitdhënësit, dhe prindërit e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta në tri qytete të Kosovës : Prishtinë, Pejë dhe Istog. Teknikat për mbledhjen e të dhënave ishin anketimi dhe intervistimi.

Duke u bazuar në rolin dhe rëndësinë që e ka mësimi në distancë, qëllimi i këtij studimi përqendrohet në hulumtimin e përvojave dhe praktikave të ndryshme të drejtorëve të shkollave, të mësimitdhënësve si dhe të prindërve për organizimin dhe realizimin e mësimit në distancë.

***Fjalët kyçe:*** drejtor, mësimitdhënës, mësimnxënie, mësimi në distancë, prindër.

## ABSTRACT

This paper presents an overview of the organization of learning in distance, giving voice to the experiences and perceptions of principals, teachers and parents on the organization of distance learning.

Learning in distance as a new form of learning, which is realized through communication technology has proved valuable and nowadays has found great use. During the elaboration of this paper I have presented the definitions for distance learning, the organization of distance learning as well as the perceptions of the most important actors in the learning and teaching process such as principals, teachers and parents.

During the research, the methods used were mixed, the qualitative (qualitative) and quantitative (quantitative) method in order to discover the perceptions and attitudes of principals, teachers and parents. The population for the selection of the sample of this study are principals, teachers, and parents of lower secondary school students in three cities of Kosovo: Prishtina, Peja and Istog. Data collection techniques will be surveys and interviews. The survey will be closed and the nature of the interview will be semi-structured.

Based on the role and importance of distance learning, the purpose of this study is to research the experiences and different practices of school principals, teachers and parents for the organization and implementation of learning in distance.

***Keywords:*** *principals, teachers, learning, learning in distance, parents.*

## **DEDIKIMI**

*Punimin ua dedikoj familjes time.*

## **FALËNDERIME**

Shpreh mirënjohje për mentorin Prof. Dr. Demë Hoti, i cili më ka ndihmuar papushim gjatë gjithë punimit, dhe falë këshillave të vlefshme që mi ka dhënë ky punim është përfunduar në mënyrën më të mirë të mundshme. Falënderoj anëtarët e komisionit dhe të gjithë profesoret e Fakultetit të Edukimit, që më dhanë mbështetje akademike dhe profesionale gjatë gjithë këtij rrugëtimi.

Falënderoj nënën, babanë, vëllaun, motrën dhe bashkëshortin që nuk e kanë kursyer asnjëherë mbështetjen e tyre financiare dhe morale gjatë gjithë studimeve të mija në Prishtinë.

*MIRE OSMANAJ CAMAJ, Prishtinë 2022*

## **PËRMBAJTJA E TEMËS**

<b>ABSTRAKT.....</b>	<b>iii</b>
<b>ABSTRACT.....</b>	<b>iv</b>
<b>DEDIKIMI.....</b>	<b>v</b>
<b>FALËNDERIME.....</b>	<b>vi</b>
<b>PËRMBAJTJA E TEMËS.....</b>	<b>vii</b>
<b>LISTA E TABELAVE.....</b>	<b>ix</b>
<b>LISTA E SHKURTESAVE.....</b>	<b>xi</b>
<b>HYRJE.....</b>	<b>2</b>
<b>KAPITULLI I PARË</b>	
<b>PËRKUFIZIMET E MËSIMIT NË DISTANCË.....</b>	<b>5</b>
<b>1.1 Ecuritë e organizimit të mësimit në distancë.....</b>	<b>7</b>
<b>KAPITULLI I DYTË</b>	
<b>ORGANIZIMI I MËSIMIT NË DISTANCË NË KOSOVË NË PERIUdhËN E PANDEMISË COVID 19.....</b>	<b>10</b>
<b>2.1.1 SKENARI C ( Rrezik i lartë) MËSIMI NË DISTANCË.....</b>	<b>10</b>
<b>2.1.2 Platforma në përdorim.....</b>	<b>10</b>
<b>2.1.3 Udhëzime metodologjike.....</b>	<b>11</b>
<b>2.1.4 Udhëzime për vlerësim.....</b>	<b>11</b>
<b>2.1.5 Udhëzime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta.....</b>	<b>12</b>
<b>2.1.6 Rekomandimet për organizimin metodik-didaktik të proceseve të mësimdhënies dhe mësimnxënies.....</b>	<b>12</b>
<b>2.1.7 Mbështetja e nxënësve në shtëpi gjatë izolimit - mësimi në distancë.....</b>	<b>14</b>
<b>2.1.8 Digjitalizimi i mësimit në shkolla-platformat, përgatitja dhe zbatimi i mësimit online.....</b>	<b>14</b>

## **KAPITULLI I TRETË**

### **PERCEPTIMET E DREJTORËVE, MËSIMDHËNËSVE DHE TË PRINDËRVE PËR ORGANIZIMIN E MËSIMIT NË DISTANCË.....16**

#### **3.1 TEMA, QËLLIMI, FUSHA DHE KUFIZIMET E HULUMTIMIT.....16**

#### **3.2 METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....17**

##### **3.2.1 Hipotezat e hulumtimit.....17**

##### **3.2.2 Metodatat dhe mjetet për mbledhjen e të dhënave.....18**

##### **3.2.3 Procesi i mostrimit.....18**

##### **3.2.4 Analiza e të dhënave.....19**

## **KAPITULLI I KATËRT**

### **ANALIZË E HULUMTIMIT ME MËSIMDHËNËS .....20**

## **KAPITULLI I PESTË**

### **ANALIZË E HULUMTIMIT ME PRINDËR.....39**

## **KAPITULLI I GJASHTË**

### **ANALIZË E PYETËSOREVE ME DREJTORËT .....51**

### **PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME.....56**

### **REFERENCAT BIOBLOGRAFIKE..... 60**

### **SHTOJCA 1: PYETËSOR PËR MËSIMDHËNËS.....62**

### **SHTOJCA 2: PYETËSOR PËR PRINDËR.....67**

### **SHTOJCA 3: PROTOKOL I INTERVISTIMIT.....71**



## LISTA E TABELAVE

<b>Tabela 1:</b> Statistikat përshkruese në lidhje me mostrën (n=167).....	20
<b>Tabela 2:</b> Shpërndarja e përgjigjeve të dhëna ndaj pyetjeve në lidhje me organizimin e mësimi në distancë.....	22
<b>Tabela 3:</b> Statistikat përshkruese në lidhje me pyetjet që masin organizimin e mësimi në distancë.....	24
<b>Tabela 4:</b> Testi KMO dhe Barlett.....	26
<b>Tabela 5:</b> Varianca totale e shpjeguar.....	26
<b>Tabela 6:</b> Rezultatet përfundimtare të analizës faktoriale.....	27
<b>Tabela 7:</b> Testi KMO dhe testi Barlett pas ripërsëritjes së analizës faktoriale.....	28
<b>Tabela 8:</b> Varianca totale e shpjeguar pas ripërsëritjes së analizës faktoriale.....	28
<b>Tabela 9:</b> Rezultatet përfundimtare të analizës faktoriale pas ripërsëritjes së saj.....	29
<b>Tabela 10:</b> Besueshmëria e matësit.....	30
<b>Tabela 11:</b> Statistikat ndërmjet pyetjeve.....	31
<b>Tabela 12:</b> Rezultatet e analizës së regresionit.....	32
<b>Tabela 13:</b> Rezultatet e testit-t për dallimet në organizimin e mësimi në distancë sipas gjinisë.....	32
<b>Tabela 14:</b> Rezultatet e analizës One-Way ANOVA.....	34
<b>Tabela 15:</b> Rezultatet e krahasimeve të shumëfishta duke përdorur testin Tukey për dallimet në organizimin e mësimi në distancë sipas moshës së mësimdhënësve.....	34
<b>Tabela 16:</b> Rezultatet e testit-t për dallimet në organizimin e mësimi në distancë sipas ciklit të arsimit të mësimdhënësve.....	36
<b>Tabela 17:</b> Rezultatet e testit-t për dallimet në organizimin e mësimi në distancë sipas vendit të punës të mësimdhënësve.....	37
<b>Tabela 1:</b> Statistikat përshkruese në lidhje me mostrën (n=60).....	38
<b>Tabela 2:</b> Shpërndarja e përgjigjeve të dhëna ndaj pyetjeve në lidhje me organizimin e mësimi në distancë.....	40

<b>Tabela 3:</b> Statistikat përshkruese në lidhje me pyetjet që masin organizimin e mësimit në distancë.....	42
<b>Tabela 4:</b> Testi KMO dhe testi Barlett.....	43
<b>Tabela 5:</b> Varianca totale e shpjeguar.....	43
<b>Tabela 6:</b> Matrica e rrotulluar e komponentëve.....	44
<b>Tabela 7:</b> Besueshmëria e matësit që mat përceptimet e prindërve në lidhje me organizimin e mësimit në distancë.....	45
<b>Tabela 8:</b> Analiza e korrelacionit ndërmjet variablave.....	45
<b>Tabela 9:</b> Rezultatet e analizës së regresionit.....	46
<b>Tabela 10:</b> Rezultatet e testit t në lidhje me dallimet në faktorët e mësimit në distancë sipas gjinisë së prindërve.....	47
<b>Tabela 11:</b> Rezultatet e analizës One-Way Anova në lidhje me dallimet sipas moshës së prindërve.....	47
<b>Tabela 12:</b> Rezultatet e krahasimeve të shumëfishta për dallimet sipas moshës.....	48
<b>Tabela 13:</b> Rezultatet e analizës One-Way Anova në lidhje me dallimet sipas edukimit të prindërve.....	49
<b>Tabela 14:</b> Rezultatet e krahasimeve të shumëfishta për dallimet sipas edukimit.....	49
<b>Tabela 15:</b> Rezultatet e testit t në lidhje me dallimet në faktorët e mësimit në distancë sipas statusit të punësimit të prindërve.....	50

## **LISTA E SHKURTESAVE**

**MASHT** : Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

**KSNA** : Klasifikimi Standard Ndërkombëtar i Arsimit

**KB**: Kurrikula Bërthamë

**UNESCO**: Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë

**LMS** : Sistemi i Menaxhimit të Mësimit

**INEE** : International Network for Education in Emergencie

## HYRJE

Arsimi përmes internetit dhe mënyrat e tij të ndryshme të zbatimit të tij është rritur në mënyrë të vazhdueshme në të gjithë botën për shkak të bashkimit të teknologjive të reja, adoptimit global të internetit, dhe intensifikimin e kërkesës për një forcë punëtore të trajnuar periodikisht për ekonominë dixhitale në zhvillim e sipër.

Sipas udhëzuesit final të përpiluar nga MASH-i, organizimi i mësimit në distancë bëhet me qëllim që të ndihmohet ruajtja e shëndetit të fëmijëve/nxënësve, mirëqenies shëndetësore të qytetarëve si dhe realizimi i procesit edukativo arsimor sipas Kornizës së Kurrikulës të Kosovës (KKK), kurrikulave bërthamë për tre nivelet të arsimit parauniversitar, dhe plan-programeve mësimore/lëndore për secilën klasë në kushte të pandemisë COVID - 19 në Republikën e Kosovës.

Për shkak të përhapjes së COVID-19, dhe mbylljes së institucioneve edukativo-arsimore, është bërë një zhvendosje e mësimit nga ai fizik në atë në distancë, për ruajtjen e shëndetit në rend të parë të nxënësve, mësimdhënësve dhe të gjithë akterëve të involvuar në sistemin e arsimit, dhe për të parë më shumë rreth qëndrimeve dhe perceptimeve që kanë pasur drejtorët, mësimdhënësit dhe prindërit për organizimin e mësimit në distancë kam zgjedhur këtë temë që mendoj se në këtë kohë është shumë aktuale, e cila na ndihmon tutje të kuptojmë se cilët janë faktorët që ndihmojnë ose pengojnë organizimin e mësimit në distancë, dhe çka duhet të ndërmarrin organet kompetente që ky proces të përmirësohet dhe të jemi në një hap me teknologjinë dhe avancimin e saj.

Situata në të cilën gjendemi ka thelluar edhe me shumë pabarazitë në mes të fëmijëve, andaj parësore është krijimi i mundësive të barabarta për t'i trajtuar dallimet e fëmijëve/nxënësve në procesin e mësimnxënies dhe nevojat e tyre të veçanta, duke kontribuar që çdo fëmijë/nxënësi t'i ofrohet mundësia që të përfshihet, shpalosë vlerat individuale, të ndjehet i pranuar, i vlerësuar dhe të përfitojë maksimalisht nga procesi edukativo arsimor.

Gjatë realizimit të procesit edukativo-arsimor, edukatorët/mësuesit duhet të jenë gjithëpërfshirës, fleksibël dhe të përdorin forma të përshtatshme të punës për fëmijët/nxënësit me nevojat të veçanta, për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, për fëmijët që jetojnë në kushte të vështira ekonomike,

për fëmijët që kanë mungesë të qasjes në teknologjinë e nevojshme për të mësuar në distancë (p.sh., internet të shpejtë ose kompjuter në shtëpi). (MASH, 2020)

### ***Qëllimi i hulumtimit***

Qëllimi kryesor i hulumtimit është që të njihemi më për së afërmi me perceptimet, mendimet, qëndrimet dhe përvojat e drejtorëve, mësimitdhënësve dhe prindërve mbi organizimin e mësimit në distancë. Po ashtu synim tjetër i hulumtimit është të arrijmë të kuptojmë dhe sfidat e përparësitë që i ka kjo metodë e të nxënësve, dhe si ka ndikuar e gjithë kjo tek nxënësit përgjatë periudhës që është aplikuar.

### ***Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza***

Ky hulumtim ka për qëllim t'i përgjigjet pyetjes kryesore:

*Cilat janë perceptimet e drejtorëve, mësimitdhënësve dhe prindërve për organizimin e mësimit në distancë?*

#### **Pyetjet mbështetëse:**

*Cilat janë disa nga sfidat për organizimin e mësimit në distancë?*

*Çfarë janë përparësitë e mësimit në distancë?*

*Çfarë janë vështirësitë karakteristike të mësimit në distancë në kushtet aktuale që ka Kosova?*

*Sa ka qenë efektiv mësimi në distancë në periudhën marsi - qershor të vitit 2020?*

Pyetjet hulumtuese janë të ndërlidhura me hipotezat.

***H<sub>1</sub>: Angazhimi mësimitdhënës-nxënës ka një efekt të rëndësishëm në mësimin në distancë.***

***H<sub>2</sub>: Efektiviteti i mësimit në distancë dallon sipas gjinisë së mësimitdhënësve.***

***H<sub>3</sub>: Angazhimi mësimitdhënës-nxënës dallon sipas gjinisë së mësimitdhënësve.***

***H<sub>4</sub>: Efektiviteti i mësimit në distancë dallon sipas moshës së mësimitdhënësve.***

***H<sub>5</sub>: Angazhimi mësimitdhënës-nxënës dallon sipas moshës së mësimitdhënësve.***

***H<sub>6</sub>: Efektiviteti i mësimit në distancë dallon sipas ciklit të arsimit të mësimitdhënësve.***

*H<sub>7</sub>: Angazhimi mësimitdhënës-nxënës dallon sipas ciklit të arsimit mësimitdhënësve.*

*H<sub>8</sub>: Efektiviteti i mësimit në distancë dallon sipas vendit të punës së mësimitdhënësve.*

*H<sub>9</sub>: Angazhimi mësimitdhënës-nxënës dallon sipas vendit të punës së mësimitdhënësve.*

Në këtë pjesë të parë është paraqitur rëndësia dhe arsyetimi për kryerjen e këtij studimi. Ky kapitull përfundon me paraqitjen e pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të studimit.

Kapitulli II ofron një përmbledhje të hollësishme të literaturës. Në Kapitullin III përshkruhet metodologjia e hulumtimit duke përfshirë karakteristikat e mostrës, instrumentet, metodat e mbledhjes së të dhënave, dhe qasja ndaj analizës.

Kapitulli IV paraqet në detaje gjetjet e studimit dhe në fund, Kapitulli V diskuton gjetjet, nxjerrë konkludimet kyçe, shtjellon pikat e forta dhe kufizimet e studimit, udhëzimet e ardhshme për kërkime, dhe implikimet për praktikën e ardhshme.

## PËRKUFIZIMET E MËSIMIT NË DISTANCË

Të mësuarit në distancë konsiderohet modalitet jotradicional i mësimdhënies. Në mësimin në distancë, përdoren mjete arsimore të cilat janë të disponueshme në media në internet, të tilla si fletë pune, libra, revista dhe ushtrime ndërvepruese. Kur krahasohet me mësimdhënien dhe mësimin frontal apo ballë për ballë, mësimi në distancë është zakonisht një trajnim ose mësim më me kosto efektive qasjeje.

Përkufizimet janë të rëndësishme për të kuptuar dhe hetuar temën. “Mësimi në distancë është një sistem arsimor i cili preferon se veprimet e të mësuarit të kryhen përmes komunikimit dhe teknologjisë nga mësuesit dhe studentët duke qenë në ambiente të ndryshme”. (Gunawardhana, 2020)

Mësimi në distancë është një nga metodat më të njohura të mëimit dhe përdoret gjerësisht në të gjithë botën. Mësimi elektronik është opsioni më i mirë aktualisht i disponueshëm për mësimin në distancë. Arsyeja kryesore për këtë është interneti. Interneti po e bën të lehtë krijimin e përmbajtjes digjitale e cila mund të ruhet, të aksesohet dhe të ndërveprohet me të dyja palët.

Sipas (Gunawardhana, 2020) mësimi elektronik si formë e mëimit përdoret shpesh pasi mbulon çdo formë të komunikimit të bazuar në kompjuter. Metodatat e e-mëimit përfshijnë kurse të bazuara në internet dhe komunikime të bazuara në kompjuter të tilla si Zoom dhe Skype. Këto lloje të e-mëimit kanë potencialin për ta bërë të mësuarit aktiv.

Shumë institucione në të gjithë botën kanë shtuar Sistemin e Menaxhimit të Mëimit (LMS). Kjo qasje e bën më të lehtë mësimin për studentët që bëjnë kohë të plotë ose me kohë të pjesshme punë gjatë javës ose ditës. Mësimi në distancë gjithashtu e bën më të lehtë menaxhimin e klasave të mëdha, ku informacionet mund të ndahen përmes internetit .

Sipas (Akhmetova, 2014) mësimi në distancë është një sistem dhe proces i të mësuarit ku mësuesi dhe nxënësit janë gjeografikisht dhe fizikisht të ndarë dhe për këtë arsye mbështeten në manuallet dhe pajisjet elektronike për organizimin e procesit arsimor; mësimi në distancë përfshin mësimdhënien në distancë (veprimtarinë e mësuesit në procesin e të mësuarit) dhe mësimin (veprimtaria njohëse e nxënësve) proceset. Secili institucion arsimor ka sistemin e vet të mëimit në distancë, mjedisin e tij arsimor që ofron një nivel të caktuar të cilësisë së arsimit.

Organizatorët e mësimi në distancë gjatë modelimit të sistemit duhet ofrojnë qasje dhe teknika të mundshme të diagnostikimit dhe mbështetjes psiko-pedagogjike të të nxëni proces në mënyrë që të sigurohet cilësia e tij. Mësimi në distancë realizohet duke përdorur teknologjitë e informacionit. Në disa raste teknologjitë e informacionit kuptohet si fushë e caktuar kërkimore, në të tjera - një mënyrë e veçantë për të punuar me informacionin, si dhe kompleks i njohurive rreth mënyrave të punës me burimet e informacionit; metodën dhe mjetet e të dhënave mbledhja, përpunimi dhe transmetimi i informacionit për të marrë informacion të ri mbi objektin e studimit. Kështu, e kuptojmë teknologjinë e informacionit si një teknologji pedagogjike, e cila karakterizohet nga një larmi mjetesh të komunikimit dhe sigurimit të informacionit për përdoruesin (shërbimet e klientit) me ndihmën e softuerit dhe hardueri (filma, audio, video, kompjuterë dhe rrjete telekomunikuese).

Absolutisht është gjithashtu e rëndësishme të theksohet disponueshmëria e komunikimit përmes programeve interaktive, të cilat përdoren gjerësisht në trajnime me përdorimin të sistemeve multimediale, të realitetit virtual. Ata lejojnë përdorimin e tekstit, grafikës, videos dhe animacionit në dialog, dhe në këtë mënyrë për të zgjeruar fushën e kompjuterit në procesin e të nxëni. Në sisteme të tilla iluzioni i "përdoruesit" vendndodhja "mes anëtarëve të tjerë të botës virtuale është krijuar. Rritja e popullaritetit të mësimi në distancë shoqërohet kryesisht me zhvillimin e informacionit modern teknologji që mund të sigurojë "efekt pranije" në klasën e nxënësit." (Akhmetova, 2014)

Sipas (Borenko, Kaisina, & Fedotova, 2018) nxitja për rritjen e aksesit dhe cilësisë së arsimit është bërë një faktor i rëndësishëm për kërkimin e ecurive të reja të bashkëpunimit të organizatave arsimore. Një lloj i tillë bashkëpunimi nënkupton aktivitetet për të krijuar mundësi për të eksploruar dhe zbatuar nivele të ndryshme arsimore.

Mundësia e përdorimit praktik të teknologjive të rrjeteve është rritur ndjeshëm për shkak të zhvillimit të teknologjive moderne të informacionit dhe komunikimit dhe përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit në atë mënyrë që të zhvillohen forma dhe metoda të reja të të mësuarit.



## *1.1 Ecuritë e organizimit të mësimi në distancë*

Mësimi në distancë është formë e arsimit, e cila realizohet përmes teknologjive moderne të komunikimit, me qëllim të mësuarit të nxënësve në vende dhe largësi të ndryshme -jashtë ambientit tradicional të mësimi (klasës). (Palvia & Aeron, 2018)

Sipas (Cacheiro-Gonzalez & Medina-Rivilla, 2020), edukimi në distancë ofron një skenar për zhvillimin e proceseve të mësimdhënies-mësimnxënies përmes platformave arsimore dhe funksionalitetet e tyre për komunikim didaktik.

Programet e mësimi në distancë ua mundësojnë nxënësve dhe mësuesve të ndërveprojnë me njëri-tjetrin nëpërmjet mjeteve kompjuterike, internetit, telefonave, radiove, televizioneve dhe teknologjive të tjera. Përderisa mësimi në distancë i referohet përvojës së të mësuarit jashtë ambientit tradicional të mësimi, edukimi në distancë nënkupton të mësuarit kur një mësues, planifikon, orienton dhe në fund e vlerëson procesin e të mësuarit. (Palvia & Aeron, 2018).

Sipas (Friedman & Friedman, 2013) forma dhe mënyra më e shpejtë në përdorimin e teknologjisë në arsim është të mësuarit në internet. Të mësuarit në internet lejonë që të këtë komunikim midis mësuesit dhe nxënësve. Për të zhvilluar këtë komunikim, mjedisi virtual i të mësuarit gjithnjë e më shumë po përdor Webin si zhvillim teknologjik, të tilla si forume diskutimi, projekte të klasës, rrjete sociale në internet dhe prezantime video në YouTube.

Hulumtimi i Benade dhe Sana, mbështet përdorimin e forumeve për diskutim për të komunikuar asinkronisht. Përdorimi i tyre ka provuar se përmirëson të mësuarit e nxënësve dhe rrisin performancën akademike të tyre. (Benade & Sana, 2019)

Mësimi në distancë është një formë e të mësuarit aktiv ku mësuesi dhe studenti janë në vende të ndara. Poashtu konsiderohet një qasje formale ndaj të mësuarit. Metodatat e përdorura mund të përfshijnë regjistrime video / audio, çdo lloji të metodës së transmetimit, mediave në internet dhe teknologjive të tjera. Programet e mësimi në distancë tashmë po ofrojnë kontribute të konsiderueshme. Një mënyrë e zakonshme e ofrimit të mësimi në distancë është përmes përdorimit të internetit dhe teknologjise, të cilat përdorin programe të ndryshme dhe instrumente të kompjuterizuar të cilët lehtësojnë dhe përmirësojnë edukimin ne distance. (Gunawardhana, 2020)

E-mësimi gjithashtu ka një tipar të dobishëm të hapjes së mundësive për të zbatuar mjedise inovative të të mësuarit, ku nxënësve u kërkohet të jenë aktivë, të pavarur, vetë-reflektues dhe bashkëpunues. Krahasuar me mësimin klasik (d.m.th., të mësuarit ballë për ballë, seminare dhe leksione) e-mësimi ka përparësi të qarta sepse jep fleksibilitetin e vendit dhe të kohës gjatë procesit të të nxënësve. Në anën tjetër, disa hulumtime zbuluan se e-mësimi ka disa disavantazhe, për shembull, ai ul procesin e socializimit të individëve për shkak të mungesës së komunikimit ballë për ballë. (Kear, 2010)

Në hulumtimin e Palvia dhe Aeron është argumentuar se pranishmëria e teknologjisë së informacionit ka ndikuar pothuajse në të gjitha aspektet e jetës sonë: mënyrën se si ne punojmë, bashkëveprojmë me të tjerët, përpunojmë të dhëna dhe informacione, analizojmë dhe ndajmë informacione, argëtojmë veten tonë, etj. (Palvia & Aeron, 2018)

Edukimi elektronik ose arsimit në internet po ndryshon mënyrën e mësimdhënies dhe të nxënësve. Ndryshimet në modelet e ofrimit të arsimit kanë qenë të shpejta dhe transformuese. Ndërsa institucionet në të gjithë botën përshtaten me këto ndryshime, ku u zgjua interes i madh midis studiuesve, arsimtarëve, administratorëve, politikëbërësve, botuesve, dhe bizneseve.

Sipas (Palvia & Aeron 2018), edukimi elektronik lehtëson metodat e ofrimit të arsimit “asinkron” si dhe “sinkron” së bashku me qasjen në panele diskutimi në internet, dhoma bisedash dhe video konferenca. Mësimi i sotëm "online" ose "i përzier" filloi në vitet 1990 me ardhjen e internetit dhe World Wide Web (www) dhe arrin individë në vendndodhje të largëta, ose që duan komoditetin e eliminimit të kohës së udhëtimit. Ndërsa teknologjitë e informacionit dhe komunikimit kanë përparuar, arsimimi në internet është bërë më e realizueshme nga ana teknologjike, ekonomike dhe operacionale.

Sipas (MASH, 2020) për realizimin me sukses të mësimin në distancë, kërkohet angazhimi i plotë i autoriteteve, institucioneve dhe i personelit arsimor në Kosovë. Realizimi i mësimin në distancë nuk është angazhim vullnetar por përmbushje e obligimeve ligjore e profesionale të puntorëve e të autoriteteve arsimore.

Në vijim jepen obligimet specifike të autoriteteve, institucioneve dhe personelit arsimor në Kosovë:

- MASH - vendos standarde, lehtë të inspektueshme, udhëzime, rregulla dhe procedura të kontrollit/monitorimit, në këtë situatë të veçantë, në përputhje me këshillat e autoriteteve relevante (IKSHPK).
- DKA - siguron procedurat e nevojshme për furnizimin me mjete për pastrim, dezinfektim etj. të bollshme dhe të nevojshme në bazë të standardeve të vendosura. Inspektorët sanitar dhe ata të punës inspektojnë në mënyrë të vazhdueshme procesin e zbatimit të standardeve të vendosura (p.sh numrin e punëtorëve teknik për m<sup>2</sup> dhe për numër të nxënësve).
- SHKOLLA - zbaton në përpikmëri udhëzimet, standardet dhe monitoron personelin teknik, sipas standardeve të vendosura (listat e kontrollit ditore, javore, mujore etj). Kujdeset që furnizimi me pajisjet e nevojshme të jetë në kohë dhe në sasi të duhur.
- PRINDËRIT - marrin pjesë në planifikimin e masave, udhëzojnë fëmijët që të respektojnë rregullat dhe standardet e higjienës në shkollë/klasë, dhe marrin pjesë në aktivitete vetëdijësuese në këtë aspekt.
- NXËNËSIT - zbatojnë rregullat e higjienës dhe promovojnë sjelljet e kujdesit të vazhdueshëm për higjienën e tyre personale dhe të ambienteve shkollore. (Mund të stimulohet kjo sjellje me disa procese rutinë: Klasa më e pastër (javës, muajit); nxënësi kampion në ruajtjen e higjienës; aktivitetet tematike (higjiena e trupit, higjiena e gojës, etj) si pjesë e edukimit shëndetësor dhe arritjes së kompetencave individ i shëndoshë dhe qytetar i përgjegjshëm. (MASHT, 2020)

# **ORGANIZIMI I MËSIMIT NË DISTANCË NË KOSOVË NË PERIUDHËN E PANDEMISË COVID 19**

## ***2.1 ORGANIZIMI I VITIT SHKOLLOR DHE I SHKOLLËS, PÛRKRAHJA E NXËNËSVE SIPAS SKENARIT C PÛR ARSIMIN FILLOR DHE ARSIMIN E MESËM TË ULËT***

Mësimi në distancë nënkupton forma të ndryshme të përgatitjes, hartimit dhe shpërndarjes së materialeve mësimore dhe të vlerësimit të dijes së nxënësit e të studentit. Kjo mund të realizohet nëpërmjet të formave më të ndryshme, si për shembull me televizion (mësimi në RTK gjatë pandemisë COVID 2020), në platforma si you-tube (mësimi gjatë Pandemisë COVID 19 në vitin 2020), me radio, me postë (formë paksa më e vjetruar por e përdorur gjerësisht gjatë shekullit 20) e të tjera. Më poshtë është paraqitur Skenari C i organizimit të mësimit në distance meqë hulumtimi fokusohet në këtë pjesë. (MASH, 2020)

### ***2.1.1 SKENARI C ( Rrezik i lartë) MËSIMI NË DISTANCË***

Sipas (MASH, 2020) ky skenar parasheh që mësimi të organizohet plotësisht nga distanca. Përveç mësimit elektronik përmes televizorit ,ku shkollat duhet të përdorin platforma të aprovuara nga DKA dhe MASHT për të mbajtur kontakt të rregullt me nxënës dhe për të dorëzuar detyra. Për klasat 1-9 të përdoret udhëzuesin E-Mësimi .

### ***2.1.2 Platforma në Përdorim***

E mësimi për Klasën 1-9 organizohet në Kanalet e RTK-së dhe në Platformën Digjitale të MASH-it, në <https://emesimi.rks-gov.net>. Platforma përmban videoligjeratat për lëndët sipas orarit për klasat 1-9 të cilat mund të ndiqen në TV apo të shikohen në çfarëdo pajisje tjetër. Ato poashtu mund të vendosen nga mësimdhënësit në platformat tjera edukative e-mësimi si e google classroom, microsoft ose e-shkollori,etj. Platforma nuk zëvendëson rolin e shkollës dhe të mësimdhënësve, por ka qëllim gjithëpërfshirjen. (MASH, 2020)

### *2.1.3 Udhëzime Metodologjike*

Sipas (MASH, 2020) platforma E mësimi dhe video ligjeratat nuk mundësojnë komunikimin me mësimdhënësit dhe bashkëmoshatarët. E mësimi përdoret në kombinim me platforma tjera, kjo sidomos për marrjen e informatave tjera shtesë, komunikimit online dhe dorëzimit të detyrave dhe informatave kthjese.

Mësimdhënësit mund të transformojnë materialet e tyre didaktike në materiale digjitale dhe të shfrytësojnë komunikimin online për shpjegime shtesë. E-mesimi përmes TVsë duhet të kombinohet me përdorimin e materialeve në platforma (online dhe offline), dhe interaktiviteti e bashkëpunimi në mes mësimdhënës/nxënës, dhe nxënës/nxënës, punë në grup dhe punë individuale.

Poashtu, delegimi i detyrave apo zgjidhjes së problemeve mos të jete uniforme për të gjithë nxënësit. Mund të ndahen në grupe, në dyse ku secili i ka të ndryshme detyrat në formë projektesh/ zgjidhje problemesh. Kjo kërkon që mësimdhënësit tu përshtaten nevojave individuale të nxënësve, dhe të krijojnë mundësi që ata të bashkëpunojnë me dhe mësojnë nga bashkëmoshatarët por edhe të regjistrohet çdo gjë nëpër të cilat kalon nxënësi.

### *2.1.4 Udhëzime për vlerësim*

Vlerësimi orientohet drejt platformave digjitale, duke pasur kujdes më shumë në mirëqenjen e nxënësve dhe vështirësitë në nxënie. Të reduktohen detyrat, dhe përqëndrimi të jetë tek arritja e rezultateve bazë.

Sugjerohet përdorimi i një platforme unike për komunikim online me nxënësit/prindërit dhe dorëzimin e detyrave. Udhëzimet për vlerësim janë detajuar në udhëzuesin për vlerësim të aprovuar nga MASHT, dhe të njëjtat shfrytëzohen gjerësisht në territorin e Republikës së Kosovës. (MASH, 2020)

### *2.1.5 Udhezime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta*

Fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta në shumicën e rasteve nuk mund të përcjellin mësimet që transmetohen në RTK andaj mësimdhënësit, varësisht për llojit dheshkalles se aftësisë se kufizuara, duhet që mësimdhënësin për keta nxënës t'a ofrojnë përmes platformave onlineme ç'rast fëmijën/ nxënësin me nevoja të veçanta e përfshijnë me gjithë klasën. Nëse përshkak të aftësisë se kufizuar ai nuk mund të marr pjesë bashkë me klasën, atëherë duhet të ofrohet përkrahje individuale duke bashkëpunuar ngushtë me prindërit/ kujdestarët, duke përgatitur aktivitetet konkrete të cilat mund merren nga Platforma asrimigjitheperfshires.net apo të hartohen dhe modifikohen vet. Në rastet kur shkolla ka mësues mbështetës dhe asistent atëherë mësimdhënësit bashkëpunojnë dhe koordinohen se bashku për t'i mbështetur nxënësit me nevoja të veçanta. Në të gjitha rastet mësuesit klasor dhe mësimdhënësit lëndor janë bartësit e aktiviteteve dhe përgjegjës për realizimin e tyre. (MASH, 2020)

### *2.16 Rekomandimet për organizimin Metodik-didaktik të Proceseve të Mësimdhënies dhe Mësimnxënies*

Për organizim metodik-didaktik të proceseve të mësimdhënies edhe në kushtet e pandemisë COVID-19, duhet të vazhdojnë të zbatohen parimet themelore të Kurrikulës së arsimit parauniversitar në Kosovë:

- Gjithëpërfshirja
- Zhvillimi i kompetencave
- Mësimdhënia dhe të nxënës të integruar dhe koherent/të ndërlidhur
- Autonomi dhe fleksibilitet në nivel shkolle
- Përgjegjësia dhe llogaridhënia

Në kushtet emergjente të organizimit të mësimin në kohë pandemie, mund të merren në konsideratë edhe disa parime shtesë, përvoja nga vendet e tjera (dokumentet e UNICEF dhe GIZ) si dhe

standardet minimale të propozuara për aspektin e mësimdhënies dhe të 26 mësimnxënies nga INEE (International Network for Education in Emergencies).

Standardi -1 -*Kurrikula*: Përmbajtjet janë relevante me kontekstin, gjuhët, nevojat dhe aspektin social të nxënësve.

Standardi 2-*Zhvillimi profesional i mësimdhënësve/Trajnimet*: Mësimdhënësit dhe personeli tjetër trajnohen sipas nevojës dhe rrethanave të krijuara.

Standardi 3- *Metodologjia e mësimdhënies* është me nxënësin në qendër, gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrje aktive.

Standardi 4- *Çmuarja dhe vlerësimi*: Metodot për vlerësim janë të përshtatshme dhe të bazuara në rezultatet e të nxënësve. (MASH, 2020)

Përhapja e Covid-19 jo vetëm që ka ndikuar në arsimim duke i mbyllur institucionet edukativo-arsimore, por ka ndikuar edhe në mirëqenien dhe mënyren e funksionimit të të gjitha palëve të involvuara në sistemin arsimor. Përveç kësaj përhapja e Covid-19 ka shkaktuar tek nxënësit frikë dhe ankth mirëpo jo vetëm nxënësit janë ndikuar nga kjo pandemi. Edhe mësimdhënësit kanë shprehur shqetësimet e tyre sa i përket realizimit të mësimin në distancë kjo për shkak të nivelit të njohurive dhe shkathtësive në përdorimin e teknologjisë dhe qasjen në teknologji. Sipas (NCIRD, 2020) përhapja e Covid-19 ka shkaktuar frikë, ankth dhe shqetësimet të tjera tek qytetarët në vende të ndryshme të botës. Sidoqoftë, niveli i shqetësimeve përgjatë të njëjtës periudhë supozohet të jetë ndikuar edhe nga faktorë të tjerë, në kuadër të grupeve të caktuara të qytetarëve të involvuar në edukim.

Shqetësimet e prindërve, përveç nga rrethanat e krijuara për shkak të izolimit social dhe faktorëve të tjerë personalë, supozohen të jenë ndikuar edhe nga mospërgatitja e prindërve për të mbështetur fëmijët e tyre me mësimin në distancë/online ose mësimin nga shtëpia, pastaj në mungesën e qasjes në teknologji, dhe në internet ose papërshtatshmërinë e formave teknologjike të përdorura për fëmijët me nevoja të veçanta në arsim, dhe vështirësitë ekonomike (UNESCO, 2020). Vështirësi të njëjta ndoshta edhe me fuqishëm e kanë shoqëruar mësimin “online” edhe në Kosovë.

### *2.1.7 Mbështetja e nxënësve në shtëpi gjatë izolimit - mësimi në distance*

Sipas (MASH, 2020) në përgjithësi, gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, iu kushtohet shumë vëmendje “njohurive të fushës” (elementet e përmbajtjes së një kurrikule, lëndët si p.sh. matematika, tema, njësia) dhe mjeteve (fletët e punës për të shkruar, letra dhe lapsa, tekste shkollore, format digjitale të të nxënësve, kompjuteri etc). Fokusi kryesor duhet të jetë te të nxënësve e nxënësit, jo vetëm tek njohuritë për fushë/lëndë apo mjetet që përdoren. “E drejta për arsim” kuptohet si “E drejta për të nxënë” - madje edhe në mungesë të arsimit formal. Prandaj, secili mësimdhënës/edukator/prind (me nxënësin në një rol aktiv dhe bashkëveprues) duhet të:

- Njohë mirë situatën e nxënësve;
- Identifikojë qëllimet kuptimplota për të mësuar në shtëpi;
- Përzgjedh fushat relevante të njohurive e kompetencave;
- Përfitojë nga mjedisi mësimor në shtëpi –duke pasur nxënësin në qendër me theks në të nxënësve e tij/saj;
- Përdor mjete dhe strategji për të mbështetur nxënësit nga distanca.

### *2.1.8 Digjitalizimi i mësimin në shkollat-platformat, përgatitja dhe zbatimi i mësimin online*

E - mësimi nuk e zëvendëson mësimin fizik për arsimin parauniversitar.

E - Mësimi (skenari 3) mund të mbahet si alternativë e vetme vetëm nëse niveli i rrezikut është shumë i lartë dhe shkollat janë mbyllur tërësisht dhe gjendja e emergjencës publike është shpallur me udhëzim total të mbylljes.

Megjithatë, strategjia e digjitalizimit dhe investimet në kohë krize, mund dhe duhet të jenë aktivitete të qëndrueshme, dhe të adresojnë çështjet urgjente, çështjet që zhvillohen në faza të njëpasnjëshme apo këto në kombinim.



Në tabelën më poshtë, janë vendosur disa elemente kryesore që duhet të kemi parasysh kur zhvillojmë politika për aplikimin e teknologjisë në edukim. Për tu realizuar mësimi online ekzistojnë disa parakushte:

- Gjithpërfshirja;
- lidhja me internet;
- posedimi i pajisjeve (nga ana e nxënësve, shkollës dhe mësimitdhënësve);
- transformimi i përmbajtjes online dhe përdorimi i platformave;
- trajnimi i mësimitdhënësve dhe shkollave për përdorimin e platformave dhe mësimitdhënien online. (MASH, 2020)

Që mësimi në distancë të jetë efikas është e domosdoshme të krijohen fillimisht kushte për realizim sa më të mirë të këtij skenari, sepse pa krijimin e kushteve elementare siç janë lidhja me internet apo posedimi i pajisjeve nga ana e të gjitha palëve mësimi në distancë nuk mund të zhvillohet dhe të realizohet, prandaj është e domosdoshme krijimi i të gjitha kushteve për organizim sa më të mirë të mësimi në distancë dhe sukses në realizim të tij. Sidoqoftë, nevoja për të zhvendosur mësimin në formatin në distancë ose online gjithashtu është vlerësuar si përparësi.

Mundësia për të arritur zhvillimet në fushën e edukimit digjital, për të cilat në rrethana të tjera do nevojiteshin vite të tëra, është konsideruar një ndër përparësitë e zhvendosjes së mësimi në formatin online (Lurvnik, 2020). Zhvendosja e mësimi në këtë format po ashtu është vlerësuar si mundësi e mirë për mësimitdhënësit dhe nxënësit që të fuqizohen, të bëhen më kreativë dhe inovativë (Yokozeki, 2020).

Poashtu sipas (Huang, 2020) Të njëjtit faktorë të cilët ndërlidhen me perspektivën e mësimitdhënësve për metodologjinë e mësimitdhënies të cilët është vërtetuar të ndikojnë në nivelin e integritit të teknologjisë në klasë, parashihet të kenë ndikim gjithashtu në realizimin e suksesshëm të mësimi online meqë zhvendosja e mësimi nga shkolla në formatin online ngërthen në vete konceptin i cili quhet “mësim fleksibil”. Sipas këtij koncepti, përkundër se mësimi zhvendoset në versionin online, duhet të jetë i atillë që stimulon të nxënit tek nxënësit dhe se kurset duhet të jenë të dizajnuara me synim mbështetjen e nevojave individuale të tyre.

## **PERCEPTIMET E DREJTORËVE, MËSIMDHËNËSVE DHE TË PRINDËRVE PËR ORGANIZIMIN E MËSIMIT NË DISTANCË**

Në këtë kapitull është paraqitur pjesa e hulumtimit të kryer. Me rradhë, tema e hulumtimit, qëllimi, fusha, kufizimet, metodologjia, ndryshoret, hipotezat, mjetet dhe metodat për mbledhjen e të dhënave, procesi i mostrimit, analizat dhe gjetjet e arritura nga hulumtimi

### ***3.1 TEMA, QËLLIMI, FUSHA DHE KUFIZIMET E HULUMTIMIT***

Në procesin e mësimdhëniës natyrisht që akterët kryesorë janë fillimisht mësimdhënësit, prindërit e gjithashtu edhe drejtorët, ku me bashkëpunimin e plotë të këtyre subjekteve vie edhe deri tek organizimi dhe realizimi i mësimit në distancë. Fokus kryesor i këtij punimi është që të nxjerrim sa më shumë informata mbi perceptimet që i kanë këto subjekte të rëndësishme në procesin e mësimdhënies, si një sfidë e re e arsimit në Kosovë që deri më tani nuk është praktikuar.

Qëllimi kryesor i hulumtimit është që të njihemi më për së afërmi me perceptimet, mendimet, qëndrimet dhe përvojat e drejtorëve, mësimdhënësve dhe prindërve mbi organizimin e mësimit në distancë. Po ashtu synim tjetër i hulumtimit është të arrijmë të kuptojmë dhe sfidat e përparësitë që i ka kjo metodë e të nxënit, dhe si ka ndikuar e gjithë kjo tek nxënësit përgjatë periudhës që është aplikuar.

Ky hulumtim ka për qëllim t'i përgjigjet pyetjes kryesore:

*Cilat janë perceptimet e drejtorëve, mësimdhënësve dhe prindërve për organizimin e mësimit në distancë?*

#### **Pyetjet mbështetese:**

*Cilat janë disa nga sfidat për organizimin e mësimit në distancë?*

*Çfarë janë përparësitë e mësimit në distancë?*

*Çfarë janë vështirësitë karakteristike të mësimit në distancë në kushtet aktuale që ka Kosova?*

*Sa ka qenë efektiv mësimi në distancë në periudhën marsi - qershor të vitit 2020?*

## **3.2 METODOLOGJIA E HULUMTIMIT**

Në këtë nën-kapitull marrin pjesë modeli i hulumtimit, hipotezat e hulumtimit, procesi i mostrimit, metodat dhe mjetet për mbledhjen e të dhënave dhe analizat e të dhënave të përfituara nga hulumtimi.

### **3.2.1 Hipotezat e hulumtimit**

***H<sub>1</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës ka një efekt të rëndësishëm në mësimin në distancë.***

Dallimet e organizimit të mësimin në distancë janë hulumtuar sipas gjinisë, moshës, edukimit, ciklit dhe vendit të punës së mësimdhënësve.

***H<sub>2</sub>: Efektiviteti i mësimin në distancë dallon sipas gjinisë së mësimdhënësve.***

Dallimi i efektivitetit për mësimin në distancë do të testohet sipas gjinisë së mësimdhënësve.

***H<sub>3</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës dallon sipas gjinisë së mësimdhënësve.***

Angazhimi i mësimdhënësve-nxënësve në mësimin në distancë do të testohet sipas gjinisë së mësimdhënësve

***H<sub>4</sub>: Efektiviteti i mësimin në distancë dallon sipas moshës së mësimdhënësve.***

Dallimi i efektivitetit për mësimin në distancë do të testohet sipas moshës së mësimdhënësve.

***H<sub>5</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës dallon sipas moshës së mësimdhënësve.***

Angazhimi i mësimdhënësve-nxënësve në mësimin në distancë do të testohet sipas moshës së mësimdhënësve

***H<sub>6</sub>: Efektiviteti i mësimin në distancë dallon sipas ciklit të arsimit të mësimdhënësve.***

Dallimi i efektivitetit për mësimin në distancë do të testohet sipas ciklit të arsimit të mësimdhënësve.

***H<sub>7</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës dallon sipas ciklit të arsimit mësimdhënësve.***

Angazhimi i mësimdhënësve-nxënësve në mësimin në distancë do të testohet sipas ciklit të arsimit të mësimdhënësve.

***H<sub>8</sub>: Efektiviteti i mësimin në distancë dallon sipas vendit të punës së mësimdhënësve.***

Dallimi i efektivitetit për mësimin në distancë do të testohet sipas vendit të punës së mësimdhënësve

***H<sub>9</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës dallon sipas vendit të punës së mësimdhënësve.***

Angazhimi i mësimdhënësve-nxënësve në mësimin në distancë do të testohet sipas vendit të punës së mësimdhënësve

### ***3.2.3 Metodatat dhe mjetet për mbledhjen e të dhënave***

Fillimisht është bërë konsultimi i literaturës për krijimin e ndryshoreve të hulumtimit.

Modeli i studimit është ***përfaqësues***, ku do të bëhet përshkrimi i perceptimit që drejtorët, mësimdhënësit, prindërit i kanë për organizimin e mësimin në distancë dhe faktorët të cilët mund të ndihmojnë apo të pengojnë atë, të nxjerra nga mendimet e subjekteve të lartë përmendura, të ndërlidhura me pjesën teorike të shtjelluar. Ndërsa si metodë e mbledhjes së të dhënave, është shfrytëzuar ***metoda e përzier***, konkretisht, metoda cilësore dhe sasiore.

Teknikat për mbledhjen e të dhënave janë ***anketimi dhe intervistimi***. Përmes teknikës së anketimit janë mbledhur perceptimet që drejtorët, mësimdhënësit dhe prindërit i kanë për organizimin e mësimin në distancë. Anketa ishte e tipit të mbyllur (duke kërkuar nga pjesëmarrësit të rrethojnë përgjigjen që u duket më e drejtë).

Në bazë të qëllimit të hulumtimit dhe pyetjes kryesore të hulumtimit si mjet më i përshtatshëm është konsideruar ***intervista***. Natyra e intervistës do të jetë ***gjysmë e strukturuar***.

Për të realizuar me sukses teknikën e hulumtimit, janë përdorur këto instrumente: ***pyetësori dhe protokollin e intervistës***.

Mbledhja e të dhënave për hulumtimin është bërë ndërmjet 26 prill- 7 maj 2021 dhe në total janë mbledhur të dhëna nga 237 vetë.

### ***3.2.4 Procesi i mostrimit***

Popullata për zgjedhjen e kampionit të këtij studimi janë drejtorët, mësime dhënësit, dhe prindërit të shollave të mesme të ulëta, në tri qytete të Kosovës : Prishtinë, Pejë dhe Istog.

Zgjedhja e kampionit është bërë *me zgjedhje të thjeshtë rastësore*, një teknikë që siguron se çdo element në popullatë ka një shans të barabartë për t'u zgjedhur në kampion.

Hulumtimi është kryer me anë të anketës direkte, ku mësime dhënësit dhe prindërit e kanë plotësuar anketën në mënyrë fizike në shkolla, në tri qytet e lartpërmendura. Për nga pikëpamja e besueshmërisë së hulumtimit, është përcjellur me kujdes koha e mbushjes së anketës. Koha e mbledhjes së anketave ka përfunduar me pranimin e anketave brenda datave 26 prill-7 maj 2021.

### ***3.2.5 Analiza e të dhënave***

Analiza e të dhënave të hulumtimit është realizuar përmes programit SPSS. Për përpunimin e të dhënave që janë nxjerrë përmes anketimit është përdorë analiza përshkruese, ose më konkretisht është bërë përmbledhje e të dhënave të mbledhura për çdo variabël, për sa i përket frekuencës, mesatares aritmetike dhe devijimit standard.

Të dhënat cilësore janë përpunuar përmes analizës tematike, ku është bërë përcaktimi i temave kryesore, më pas interpretimet fillestare dhe vendosja e tyre në kategori përkatëse, që i korespondojnë hulumtimit.

## ANALIZË E HULUMTIMIT ME MËSIMDHËNËS

Të dhënat e mbledhura nga ky hulumtim janë analizuar me anë të programit SPSS.

### Të dhënat përshkruese

Në vazhdim janë paraqitur statistikat bazike në lidhje me të gjitha variablat e pyetësorit. Fillimisht janë paraqitur frekuencat dhe pastaj mesatarja dhe devijimi standard.

**Tabela 1:** Statistikat përshkruese në lidhje me mostrën (n=167)

Variablat		Frekuencat	Përqindja	Mesatarja	Devijimi Std.																																																									
Gjinia	Femër	121	72,5	1,2754	0,44808																																																									
	Mashkull	46	27,5			Moshë	Më pak se 25	8	4,8	2,9401	0,87606	26-35	45	26,9	36-45	63	37,7	Më shumë se 46	51	30,5	Edukimi	Shkollë e mesme	2	1,2	3,1198	0,52414	SHLP	8	4,8	Bachelor	125	74,9	Master	32	19,2	Cikli mësimor	Arsim fillor	96	57,5	1,4431	0,54447	Arsim i mesëm i ulët	69	41,3	Arsim i mesëm i lartë	2	1,2	Vendi	Fshat	88	52,7	1,4731	0,50077	Qytet	79	47,3	Angazhimi online	Po	165	98,8	1,0120	0,10911
Moshë	Më pak se 25	8	4,8	2,9401	0,87606																																																									
	26-35	45	26,9																																																											
	36-45	63	37,7																																																											
	Më shumë se 46	51	30,5																																																											
Edukimi	Shkollë e mesme	2	1,2	3,1198	0,52414																																																									
	SHLP	8	4,8																																																											
	Bachelor	125	74,9																																																											
	Master	32	19,2																																																											
Cikli mësimor	Arsim fillor	96	57,5	1,4431	0,54447																																																									
	Arsim i mesëm i ulët	69	41,3																																																											
	Arsim i mesëm i lartë	2	1,2																																																											
Vendi	Fshat	88	52,7	1,4731	0,50077																																																									
	Qytet	79	47,3																																																											
Angazhimi online	Po	165	98,8	1,0120	0,10911																																																									
	Jo	2	1,8																																																											

Shikimi i mater. Audiovizive	Po	164	98,2	1,0180	0,13322
	Jo				
Përdorimi i platformave online	Po	167	100,00	1,0000	0,00000

Tabela 1 jep statistikën përshkruese në lidhje me mostrën. Në hulumtimin me mësimdhënësit, kanë marrur pjesë në total 167 mësimdhënëse, 121 prej të cilëve i përkasin gjinisë femërore dhe 46 gjinisë mashkullore. 4,8% e mësimdhënësve pjesëmarrës kanë më pak se 25 vite, 26,9% gjenden në intervalin e moshës prej 26-35 vjeç, 37,7% 36-45 vjeç dhe 30,5% kanë më shumë se 46 vite. Në lidhje me nivelin e tyre të edukimit, 1,2% e mësimdhënësve kanë të përfunduar vetëm shkollën e mesme, 4,8% e tyre kanë të përfunduar shkollën e lartë pedagogjike, ndërsa 74,9% kanë të përfunduar nivelin e studimeve baçelor dhe 19,2% e tyre kanë të përfunduar nivelin e masterit.

Në lidhje me pyetjen e pozitës e cila merr pjesë në pyetësor, të gjitha pjesëmarrësit kanë raportuar se janë mësimdhënëse, prandaj rezultatet e kësaj pyetje nuk i kemi paraqitur në tabelë.

Në vazhdim, 57,5% e mësimdhënësve punojnë me ciklin e arsimit fillor, 41,3% me ciklin e arsimit të mesëm të ulët dhe vetëm 1,2% në ciklin e arsimit të mesëm të lartë, ku këta të fundit punojnë edhe në ciklin e mesëm të ulët. 52,7% e mësimdhënësve të përfshirë në hulumtim punojnë në shkollat në fshat dhe 47,3% në qytet. 98,8% e mësimdhënësve kanë qenë të angazhuar online gjatë kohës së pandemisë, kurse 1,8% nuk kanë qenë të angazhuar.

Megjithatë hulumtimi jonë përfshin matjen e perceptimeve në lidhje me organizimin e mësimin në distancë, 2 mësimdhënësit e cekur të cilët nuk kanë qenë të angazhuar me mësimet online, janë larguar nga seti i të dhënave për arsye të analizimit të të dhënave. 98,2% e mësimdhënësve të hulumtuar i kanë parë materialet audiovizive të transmetuara në programin RTK1 dhe RTK4. Në fund, të gjithë mësimdhënësit përdorin platformat online për komunikimin me nxënësit e tyre për përmbajtjet ose temat mësimore. Nga platformat më të përdorura kanë qenë aplikacioni Zoom, Viber dhe Whatsapp.

Krahas frekuencave për këto variabla, në Tabelën 1 janë paraqitur edhe mesatarja dhe devijimi standard për secilën variabël. Analizat e tjera statistikore janë vazhduar me përgjigjet e gjithsej 164 pjesëmarrësve, pasi edhe një person i tretë është eliminuar nga seti i të dhënave për shkak të mungesës së të dhënave në pyetësor.

Në tabelën 2 janë paraqitur shpërndarjet e frekuencave dhe përqindjeve për katërmbëdhjetë pyetjet të cilat masin organizimin e mësimit në distancë. Siç mund të shihet nga tabela, shpërndarjet për secilën alternativë të përgjigjeve janë të ndryshme, prandaj nga këto të dhëna nuk mund të nxirret ndonjë konkluzion i prerë.

**Tabela 2:** Shpërndarja e përgjigjeve të dhëna ndaj pyetjeve në lidhje me organizimin e mësimit në distancë

	Pajtohem plotësisht		Pajtohem		Neutral		Nuk pajtohem		Nuk pajtohem fare	
	F	%	F	%	F	%	F	%	F	%
A pajtoheni se ju pëlqen ndërveprimi me nxënësit në formë elektronike?	17	10,4	39	23,8	38	23,2	35	21,3	35	21,3
A pajtoheni se integrimi i teknologjisë në mësimin në distancë ishte sfiduese?	44	26,8	51	31,1	25	15,2	23	14,0	21	12,8
A pajtoheni se përparësi e mësimit në distancë është organizimi i kohës dhe punës për mësimit?	28	17,1	42	25,6	34	20,7	36	22,0	24	14,6
A pajtoheni se mësimi në distancë ka ndikim pozitiv në mbështetjen e të nxënësve?	21	12,8	39	23,8	38	23,2	44	26,8	22	13,4
A pajtoheni se keni pasur vështirësi në qasje dhe përshtatshmëri në pajisjet teknologjike për mësimin në distancë?	47	28,7	51	31,1	18	11,0	23	14,0	25	15,2



A pajtoheni se komunikoni rregullisht me nxënësit, prindërit e tyre dhe me drejtuesit e institucionit arsimor që nxënësit të jenë të angazhuar për mësimet në kushtet e shtëpisë?	51	31,1	62	37,8	26	15,9	17	10,4	8	4,9
A pajtoheni se jepni udhëzime në grupin e krijuar, në lidhje me përvetësimin e përmbajtjes mësimore nëpërmjet mesazheve dhe videove të përgatitura?	48	29,3	64	39,0	22	13,4	16	9,8	14	8,5
A pajtoheni se iu përgjigjini pyetjeve që adresojnë nxënësit në lidhje me përmbajtjen/temat mësimore?	56	34,1	65	39,6	15	9,1	15	9,1	13	7,9
A pajtoheni se nxënësit kanë vështirësi në qasjen për mësim në distancë?	71	43,3	44	26,8	19	11,6	20	12,2	10	6,1
A pajtoheni se jeni fleksibil në trajtimin e nevojave të nxënësve gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë?	50	30,5	70	42,7	23	14,0	15	9,1	6	3,7
A pajtoheni se mësimi efektiv mund të zhvillohet edhe pa ndërvepruar me nxënësit ballë për ballë?	38	23,2	34	20,7	47	28,7	23	14,0	22	13,4
A pajtoheni se mësimi në distancë ka qenë efektiv në periudhën mars-qershor të vitit 2020?	23	14,0	36	22,0	38	23,2	46	28,0	21	12,8
A pajtoheni se gjatë mësimin në distancë nxënësit jo vetëm kanë përsëritur njohuritë e fituara më parë, por kanë përvetësuar edhe njohuri të reja?	23	14,0	35	21,3	46	28,0	40	24,4	20	12,2
A pajtoheni se jeni të kënaqur me angazhimin e nxënësve gjatë procesit në distancë?	17	10,4	48	29,3	40	24,4	40	24,4	19	11,6

**Tabela 3:** Statistikat përshkruese në lidhje me pyetjet që masin organizimin e mësimit në distancë

	Vlera min.	Vlera maks.	Mesatarja	Devijimi Std.
A pajtoheni se ju pëlqen ndërveprimi me nxënësit në formë elektronike?	1.00	5.00	3.1951	1.30067
A pajtoheni se integrimi i teknologjisë në mësimin në distancë ishte sfiduese?	1.00	5.00	2.5488	1.35802
A pajtoheni se përparësi e mësimit në distancë është organizimi i kohës dhe punës për mësim?	1.00	5.00	2.9146	1.32184
A pajtoheni se mësimi në distancë ka ndikim pozitiv në mbështetjen e të nxënësve të nxënësve?	1.00	5.00	3.0427	1.25003
A pajtoheni se keni pasur vështirësi në qasje dhe përshtatshmëri në pajisjet teknologjike për mësimin në distancë?	1.00	5.00	2.5610	1.42370
A pajtoheni se komunikoni rregullisht me nxënësit, prindërit e tyre dhe me drejtuesit e institucionit arsimor që nxënësit të jenë të angazhuar për mësimet në kushtet e shtëpisë?	1.00	5.00	2.2012	1.13602
A pajtoheni se jepni udhëzime në grupin e krijuar, në lidhje me përvetësimin e përmbajtjes mësimore nëpërmjet mesazheve dhe videove të përgatitura?	1.00	5.00	2.2927	1.22837
A pajtoheni se iu përgjigjini pyetjeve që adresojnë nxënësit në lidhje me përmbajtjen/temat mësimore?	1.00	5.00	2.1707	1.22153
A pajtoheni se nxënësit kanë vështirësi në qasjen për mësim në distancë?	1.00	5.00	2.1098	1.25816
A pajtoheni se jeni fleksibil në trajtimin e nevojave të nxënësve gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë?	1.00	5.00	2.1280	1.06336
A pajtoheni se mësimi efektiv mund të zhvillohet edhe pa ndërvepruar me nxënësit ballë për ballë?	1.00	5.00	2.7378	1.32398
A pajtoheni se mësimi në distancë ka qenë efektiv në periudhën mars-qershor të vitit 2020?	1.00	5.00	3.0366	1.25757
A pajtoheni se gjatë mësimit në distancë nxënësit jo vetëm kanë përsëritur njohuritë e fituara më parë, por kanë përvetësuar edhe njohuri të reja?	1.00	5.00	2.9939	1.23098
A pajtoheni se jeni të kënaqur me angazhimin e nxënësve gjatë procesit në distancë?	1.00	5.00	2.9756	1.19278

Në tabelën 3 janë paraqitur disa nga statistikat bazë në lidhje me pyetjet që masin organizimin e mësimit në distancë. Prej këtyre statistikave janë përdorur, vlera minimale, vlera maksimale, mesatarja dhe devijimi standard.

Siç mund të vërehet, vlera minimale për të gjitha pyetjet është 1, kurse vlera maksimale për të gjitha pyetjet është 5. Kjo nënkupton se për secilën pyetje, të paktën një herë është përzgjedhur alternativa 1 (e cila nënkupton plotësisht pajtohem) dhe të paktën njëherë është përzgjedhur alternativa 5 (e cila nënkupton nuk pajtohem fare).

Pastaj është paraqitur mesatarja dhe devijimi standard për secilën pyetje veç e veç. Meqë këtu nuk është qëllimi që të nxjerrim përfundime duke shikuar vetëm statistikat përshkruese, këto statistika nuk janë përshkruar më tej. Në vazhdim, është bërë analiza faktoriale dhe pastaj ajo e besueshmërisë, për të testuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e këtij matësi, të përbërë prej katërbëdhjetë pyetje.

## VLEFSHMËRIA DHE BESUESHMËRIA E MATËSIT QË MAT ORGANIZIMIN E MËSIMIT NË DISTANCË

### Vlefshmëria e Matësit

**Tabela 4:** Testi KMO dhe Barlett

Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy.		.896
Bartlett's Test of Sphericity	Approx. Chi-Square	2055.553
	Df	91
	Sig.	.000

Kushti i parë i analizës faktoriale është përshtatshmëria e setit të të dhënave me analizën faktoriale. Testi KMO dhe testi Barlett tregojnë nëse seti i të dhënave është i përshtatshëm për kryerjen e kësaj analize. Vlera e testit KMO në Tabelën 4 është 0,896, e cila është më e madhe se 0,50 dhe kjo tregon se seti i të dhënave është shumë i përshtatshëm për analizën faktoriale. Në mënyrë të ngjashme, vlera e testit Barlett, e cila është signifikante,  $p < 0,05$  tregon që seti i të dhënave është i përshtatshëm për aplikimin e analizës faktoriale.

**Tabela 5:** Varianca totale e shpjeguar

Komponentët	Vlerat Eigen fillestare			Rrotullimi i shumës së ngarkesave në katrorë		
	Total	% e variancës	% kumulative	Total	% e variancës	% kumulative
1	7.161	51.147	51.147	5.285	37.752	37.752
2	2.791	19.932	71.080	4.666	33.328	<b>71.080</b>
3	.834	5.955	77.034			
4	.618	4.416	81.450			
5	.539	3.849	85.300			
6	.442	3.155	88.455			
7	.400	2.856	91.311			
8	.340	2.426	93.737			
9	.226	1.615	95.352			
10	.194	1.383	96.735			
11	.147	1.051	97.786			
12	.133	.951	98.737			
13	.106	.754	99.491			
14	.071	.509	100.000			

Tabela 5 jep rezultatet e variancës totale të shpjeguar nga kombinimi i katërmbëdhjetë pyetjeve. Në fund të analizës janë përfituar dy faktorë nga katërmbëdhjetë pyetje. Faktori i parë e shpjegon variancën 37,752%, kurse faktori i dytë e shpjegon variancën prej 33,328%. Varianca totale e shpjeguar është 71,080% dhe kjo është vlerë mjaft e lartë.

**Tabela 6:** Rezultatet përfundimtare të analizës faktoriale

	Faktorët	
	1	2
A pajtoheni se mësimi në distancë ka qenë efektiv në periudhën mars-qershor të vitit 2020?	.786	
A pajtoheni se gjatë mësimin në distancë nxënësit jo vetëm kanë përsëritur njohuritë e fituara më parë, por kanë përvetësuar edhe njohuri të reja?	.773	
A pajtoheni se keni pasur vështirësi në qasje dhe përshtatshmëri në pajisjet teknologjike për mësimin në distancë?	-.760	
A pajtoheni se ju pëlqen ndërveprimi me nxënësit në formë elektronike?	.748	
A pajtoheni se jenë të kënaqur me angazhimin e nxënësve gjatë procesit në distancë?	.727	
A pajtoheni se mësimi në distancë ka ndikim pozitiv në mbështetjen e të nxënimit të nxënësit?	.712	
A pajtoheni se mësimi efektiv mund të zhvillohet edhe pa ndërvepruar me nxënësit ballë për ballë?	.709	
A pajtoheni se integrimi i teknologjisë në mësimin në distancë ishte sfiduese?	-.700	
A pajtoheni se nxënësit kanë vështirësi në qasjen për mësim në distancë?	-.644	
A pajtoheni se përparësi e mësimin në distancë është organizimi i kohës dhe punës për mësim?	.629	
A pajtoheni se jepni udhëzime në grupin e krijuar, në lidhje me përvetësimin e përmbajtjes mësimore nëpërmjet mesazheve dhe videove të përgatitura?		.932
A pajtoheni se jeni fleksibil në trajtimin e nevojave të nxënësve gjatë mësimin në kushtet e shtëpisë?		.915
A pajtoheni se komunikoni rregullisht me nxënësit, prindërit e tyre dhe me drejtuesit e institucionit arsimor që nxënësit të jenë të angazhuar për mësimet në kushtet e shtëpisë?		.911
A pajtoheni se iu përgjigjini pyetjeve që adresojnë nxënësit në lidhje me përmbajtjen/temat mësimore?		.907

Në tabelën 6 janë prezantuar rezultatet përfundimtare të analizës faktoriale, matrica e komponentëve të rrotulluar. Duke përdorur metodën varimax të rrotullimit, rrotullimi është realizuar në 3 përsëritje. Në fund të këtij rrotullimi, katërbëdhjetë pyetjet e matësit janë pëmbledhur në dy faktorë. Faktori i parë ka dhjetë pyetje, kurse faktori i dytë ka katër pyetje. Mirëpo, për shkak që në faktorin e parë ekzistojnë tri pyetje të cilat kanë ngarkesë negative (-0,760, -0,700 dhe -0,644) nën faktorin e parë, është vendosur që këta faktorë të largohen nga matësi. Si rezultat, analiza faktoriale është ripërsëritur.

**Tabela 7:** Testi KMO dhe testi Barlett pas ripërsëritjes së analizës faktoriale

Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy.		.902
Bartlett's Test of Sphericity	Approx. Chi-Square	1812.311
	Df	55
	Sig.	.000

Në Tabelën 7 janë paraqitur rezultatet e testit KMO dhe Barlett pas ribërjes së analizës faktoriale. Në këtë rast, vlera e testit KMO është rritur në 0,902 dhe testi Barlett është ende signifikant. Përsëri, të dhënat e hulumtimit tonë janë mjaft të përshtatshme për kryerjen e analizës faktoriale.

**Tabela 8:** Varianca totale e shpjeguar pas ripërsëritjes së analizës faktoriale

Komponentët	Vlerat Eigen fillestare			Rrotullimi i shumës së ngarkesave në katrorë		
	Total	% e variancës	% kumulative	Total	% e variancës	% kumulative
1	6.750	61.368	61.368	4.895	44.504	44.504
2	1.906	17.327	78.695	3.761	34.191	<b>78.695</b>
3	.625	5.686	84.381			
4	.443	4.025	88.406			
5	.350	3.179	91.585			
6	.244	2.218	93.804			
7	.205	1.863	95.667			
8	.149	1.356	97.023			
9	.142	1.293	98.316			
10	.113	1.023	99.339			
11	.073	.661	100.000			

Pas nxjerrjes së tri pyetjeve të cilat kishin ngarkesë negative, tani mund të shohim se analiza faktoriale është kryer me 11 pyetje. Si rezultat, dy faktorë kanë vlerën Eigen më të madhe se 1. Faktori i parë shpjegon 44,504% të variancës totale, kurse faktori i dytë shpjegon 34,191% të variancës totale. Bashkarisht, këta dy faktorë shpjegojnë 78,695% të variancës totale, kjo vlerë e cila është shumë e lartë dhe që tregon se 11 pyetjet e përfshira në hulumtim, masin në mënyrë mjaft të kënaqshme organizimin e mësimit në distancë.

**Tabela 9:** Rezultatet përfundimtare të analizës faktoriale pas ripërsëritjes së saj

	Faktori	
	1	2
A pajtoheni se gjatë mësimit në distancë nxënësit jo vetëm kanë përsëritur njohuritë e fituara më parë, por kanë përvetësuar edhe njohuri të reja?	.874	
A pajtoheni se mësimi në distancë ka qenë efektiv në periudhën mars-qershor të vitit 2020?	.864	
A pajtoheni se ju pëlqen ndërveprimi me nxënësit në formë elektronike?	.817	
A pajtoheni se mësimi në distancë ka ndikim pozitiv në mbështetjen e të nxënësve?	.809	
A pajtoheni se jeni të kënaqur me angazhimin e nxënësve gjatë procesit në distancë?	.788	
A pajtoheni se mësimi efektiv mund të zhvillohet edhe pa ndërvepruar me nxënësit ballë për ballë?	.764	
A pajtoheni se përparësi e mësimit në distancë është organizimi i kohës dhe punës për mësime?	.755	
A pajtoheni se jepni udhëzime në grupin e krijuar, në lidhje me përvetësimin e përmbajtjes mësimore nëpërmjet mesazheve dhe videove të përgatitura?		.921
A pajtoheni se iu përgjigjini pyetjeve që adresojnë nxënësit në lidhje me përmbajtjen/temat mësimore?		.912
A pajtoheni se jeni fleksibil në trajtimin e nevojave të nxënësve gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë?		.910
A pajtoheni se komunikoni rregullisht me nxënësit, prindërit e tyre dhe me drejtuesit e institucionit arsimor që nxënësit të jenë të angazhuar për mësime në kushtet e shtëpisë?		.900
Extraction Method: Principal Component Analysis.		
Rotation Method: Varimax ëith Kaiser Normalization.		
a. Rotation converged in 3 iterations.		

Pasi e përsëritën analizën faktoriale, rezultati vazhdon të mbetet i njëjtë. Tri pyetjet me ngarkesë negative janë larguar nga matësi dhe dy faktorë kanë rezultuar nga analiza faktoriale. Faktori i parë ka 7 pyetje, kurse faktori i dytë ka katër pyetje. Pyetjet në faktorin e parë kanë të bëjnë me efektivitetin e mësimit në distancë, prandaj këtë faktor mund ta emërojmë si “**efektiviteti i mësimit në distancë (EMD)**”. Pyetjet e faktorit të dytë kanë të bëjnë me angazhimin e mësimit në distancë me nxënësit e tyre, prandaj këtë faktor mund ta emërojmë si “**angazhimi mësimit në distancë (AMN)**”.

Pas analizës faktoriale, është performuar analiza e besueshmërisë për matësin në përgjithësi dhe për faktorët veç e veç.

### **Besueshmëria e Matësit**

**Tabela 10:** Besueshmëria e matësit

	<b>Cronbach’s Alpha</b>	<b>Numri i pyetjeve</b>
Matësi i përgjithshëm	.936	11
Efektiviteti i mësimit në distancë – EMD	.934	7
Angazhimi mësimit në distancë – AMN	.962	4

Tabela 10 jep rezultatet e besueshmërisë së matësit. Në rastin e parë, kur janë përfshirë të gjitha pyetjet e matësit, koeficienti i besueshmërisë Cronbach’s Alpha është 0,936, e cila si vlerë është mjaft e lartë dhe tregon se matësi është në shkallë të lartë i besueshëm për matjen e organizimit të mësimit në distancë. Në rastin e dytë, është testuar besueshmëria e faktorit të parë dhe të dytë të nxjerrur nga analiza faktoriale. Koeficienti i besueshmërisë për efektivitetin e mësimit në distancë (EMD) është 0,934 dhe koeficienti i besueshmërisë për angazhimin mësimit në distancë është 0,962. Të dy këto vlera janë të larta dhe tregojnë për nivelin e lartë të besueshmërisë së faktorëve të përfituar nga analiza faktoriale.

Përveç kësaj, statistikën në Tabelën 11 tregojnë për besueshmërinë e matësit. Në këtë tabelë janë paraqitur mesatarja, varianca, korrelacioni dhe koeficienti Cronbach’s Alpha nëse një pyetje e caktuar fshihet nga matësi. Mund të shihet se të gjitha korrelacionet janë të larta, të gjitha mbi vlerën 0,50. Në të njëjtën kohë, me rastin e fshirjes së ndonjë pyetje, besueshmëria e matësit nuk do të ndryshonte. Sidoqoftë, besueshmëria e matësit është shumë e lartë dhe nuk ka nevojë që të fshihet ndonjë pyetje tjetër nga matësi.



**Tabela 11:** Statistikat ndërmjet pyetjeve

	<b>Mesatarja</b>	<b>Varianca</b>	<b>Korrelacioni</b>	<b>Cronbach's Alpha</b>
A pajtoheni se ju pëlqen ndërveprimi me nxënësit në formë elektronike?	26.4939	91.932	.743	.930
A pajtoheni se përparësi e mësimit në distancë është organizimi i kohës dhe punës për mësimit?	26.7744	90.912	.773	.928
A pajtoheni se mësimi në distancë ka ndikim pozitiv në mbështetjen e të nxënësve të nxënësve?	26.6463	92.340	.760	.929
A pajtoheni se komunikoni rregullisht me nxënësit, prindërit e tyre dhe me drejtuesit e institucionit arsimor që nxënësit të jenë të angazhuar për mësimit në kushtet e shtëpisë?	27.4878	94.300	.751	.930
A pajtoheni se jepni udhëzime në grupin e krijuar, në lidhje me përvetësimin e përmbajtjes mësimore nëpërmjet mesazheve dhe videove të përgatitura?	27.3963	93.676	.714	.931
A pajtoheni se iu përgjigjini pyetjeve që adresojnë nxënësit në lidhje me përmbajtjen/temat mësimore?	27.5183	94.632	.675	.933
A pajtoheni se jeni fleksibil në trajtimin e nevojave të nxënësve gjatë mësimit në kushtet e shtëpisë?	27.5610	96.248	.708	.931
A pajtoheni se mësimi efektiv mund të zhvillohet edhe pa ndërvepruar me nxënësit ballë për ballë?	26.9512	93.470	.661	.933
A pajtoheni se mësimi në distancë ka qenë efektiv në periudhën mars-qershor të vitit 2020?	26.6524	92.130	.764	.929
A pajtoheni se gjatë mësimit në distancë nxënësit jo vetëm kanë përsëritur njohuritë e fituara më parë, por kanë përvetësuar edhe njohuri të reja?	26.6951	91.894	.794	.928
A pajtoheni se jeni të kënaqur me angazhimin e nxënësve gjatë procesit në distancë?	26.7134	94.549	.698	.932

## Ndikimi i Angazhimit Mësimdhënës-Nxënës në Efektivitetin e Mësimin në Distançë

*H<sub>1</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës ka një efekt të rëndësishëm në efektivitetin e mësimin në distancë.*

**Tabela 12:** Rezultatet e analizës së regresionit

Variabla e varur	Variabla e pavarur	B	T	p	F	Model (p)	R	R <sup>2</sup>
EMD	Konstantja	1.819	11.553	.000	68.683	.000	.546	.298
	AMN	.531	8.288	.000				

Për testimin e kësaj hipoteze është përdorur analiza e regresionit linear. Në tabelën 12 janë paraqitur rezultatet e analizës së regresionit. Vlera R është 0,546 kurse vlera R<sup>2</sup> është 0,298. Vlera R<sup>2</sup> tregon se 29,8% e ndryshimit në variablën e varur shpjegohet nga variabla e pavarur, me fjalë të tjera, 29,8% e ndryshimit në efektivitetin e mësimin në distancë shpjegohet nga angazhimi mësimdhënës-nxënës dhe ky model i regresionit është i rëndësishëm (F=68,683, p<0,01). Koeficienti beta tregon se AMN-ja (angazhimi mësimdhënës-nxënës) ka një efekt prej  $\beta=0,531$  në EMD (efektivitetin e mësimin në distancë). Ky efekt është i rëndësishëm, p<0,01).

### Dallimet e Mësimin në Distançë Sipas Karakteristikave Demografike të Mësimdhënësve

Dallimet e organizimit të mësimin në distancë janë hulumtuar sipas gjinisë, moshës, edukimit, ciklit dhe vendit të punës së mësimdhënësve.

*H<sub>2</sub>: Efektiviteti i mësimin në distancë dallon sipas gjinisë së mësimdhënësve.*

*H<sub>3</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës dallon sipas gjinisë së mësimdhënësve.*

**Tabela 13:** Rezultatet e testit-t për dallimet në organizimin e mësimin në distancë sipas gjinisë

	Gjinia	N	Mesatarja	Devijimi Std.	F	Sig. (2-tail)
<b>EMD</b>	Femër	119	2.922	1.090	.326	.221
	Mashkull	45	3.152	1.019		
<b>AMN</b>	Femër	119	2.073	1.033	5.530	.018
	Mashkull	45	2.527	1.223		

Në tabelën 13 janë paraqitur rezultatet e testit-t në lidhje me dallimet në organizimin e mësimit në distancë sipas gjinisë. Me fjalë të tjera, është hulumtuar nëse ekziston ndonjë dallim në perceptimet e mësimitdhënësve femra dhe mësimitdhënësve meshkuj sa i përket organizimit të mësimit në distancë.

Meqë organizimi i mësimit në distancë ishte përmbledhur në dy faktorë, efektiviteti i mësimit në distancë dhe angazhimi mësimitdhënës-nxënës, dallimet janë hulumtuar për këta dy faktorë. Sa i përket faktorit të parë, efektiviteti i mësimit në distancë, vlera e testit t ( $F=0,326$ ,  $p>0,05$ ) tregon se nuk ekziston ndonjë dallim i rëndësishëm ndërmjet mësimitdhënësve femra dhe meshkuj. Mesatarja e mësimitdhënësve femra është 2,922 dhe mesatarja e mësimitdhënësve meshkuj është 3,152. Ky dallim nuk është signifikant.

Sa i përket angazhimit mësimitdhënës-nxënës, vlera e testit t ( $F=5,530$ ,  $p<0,05$ ) tregon se ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet mësimitdhënësve femra dhe meshkuj. Mesatarja e mësimitdhënësve femra është 2,073 dhe mesatarja e mësimitdhënësve meshkuj është 2,527.

Ky dallim është signifikant dhe tregon se mësimitdhënësit femra janë më shumë të angazhuar me nxënësit se mësimitdhënësit meshkuj (1-pajtohem plotësisht, 2-pajtohem, 3-neutral...). Pra mësimitdhënësit femra pajtohen më shumë me pyetjet të cilat masin angazhimin mësimitdhënës-nxënës sesa mësimitdhënësit meshkuj.

Si rezultat, hipoteza  $H_2$ : Efektiviteti i mësimit në distancë dallon sipas gjinisë së mësimitdhënësve **është refuzuar** dhe hipoteza  $H_3$ : Angazhimi mësimitdhënës-nxënës dallon sipas gjinisë së mësimitdhënësve **është pranuar**.

***H<sub>4</sub>: Efektiviteti i mësimit në distancë dallon sipas moshës së mësimitdhënësve.***

***H<sub>5</sub>: Angazhimi mësimitdhënës-nxënës dallon sipas moshës së mësimitdhënësve.***

Për testimin e këtyre dy hipotezave është përdorur analiza One-Way ANOVA.

**Tabela 14:** Rezultatet e analizës One-Way ANOVA

		<b>Shuma e katrorëve</b>	<b>df</b>	<b>Katrori mesatar</b>	<b>F</b>	<b>Sig.</b>
EMD	Ndërmjet grupeve	29.083	3	9.694	<b>9.772</b>	<b>.000</b>
	Brenda grupeve	158.738	160	.992		
	Total	187.821	163			
AMN	Ndërmjet grupeve	28.907	3	9.636	<b>9.087</b>	<b>.000</b>
	Brenda grupeve	169.652	160	1.060		
	Total	198.559	163			

Tabela 14 prezanton rezultatet e analizës One-Ëay ANOVA. Në rastin e parë kur janë hulumtuar dallimet në efektivitetin e mësimit në distancë, vlera  $F=9,772$  dhe vlera  $Sig=0,000$  tregojnë se ekziston një dallim në efektivitetin e mësimit në distancës sipas moshës së mësimeve. Edhe në rastin e dytë, vlera  $F=9,087$  dhe vlera  $Sig=0,000$  tregojnë se ekziston një dallim i rëndësishëm në angazhimin mësimeve-nxënës sipas moshës së mësimeve. Për gjetjen e këtyre dallimeve, është përdorur tabela e Krahasimeve të Shumëfishta dhe testi Tukey për hulumtimin e këtyre dallimeve.

Në tabelën 15 janë paraqitur këto dallime të mësimeve. Sa i përket faktorit të parë, ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet mësimeve të moshës nën 25 vjeç me mësimeve të moshës 36-45 dhe më shumë se 46 vjeç. Dallimi i mësimeve të moshës nën 25 vjeç me mësimeve të moshës 36-45 vjeç është  $-1,062$  dhe me ata të moshës më shumë se 46 vjeç është  $-1,602$ . Këto vlera tregojnë se mësimeve të moshës nën moshën 25 vjeç pajtohen më pak me pyetjet e efektivitetit të mësimit në distancë, pra, mësimeve të moshës 36-45 vjeç dhe ata më shumë se 46 vjeç kanë qenë më efektiv me mësimin në distancë se mësimeve të moshës më të re.

**Tabela 15:** Rezultatet e krahasimeve të shumëfishta duke përdorur testin Tukey për dallimet në organizimin e mësimit në distancë sipas moshës së mësimeve

<b>Variabla e Varur</b>	<b>(I) mosha</b>	<b>(J) mosha</b>	<b>Dallimi mesatar (I-J)</b>	<b>Gabimi Std.</b>	<b>Sig.</b>
EMD	Më pak se 25	26-35	-.69968	.38283	.264
		<b>36-45</b>	<b>-1.06207*</b>	.37385	<b>.026</b>
		<b>Më shumë se 46</b>	<b>-1.60241*</b>	.37982	<b>.000</b>
	26-35	Më pak se 25	.69968	.38283	.264
		36-45	-.36240	.19569	.253
		<b>Më shumë se 46</b>	<b>-.90273*</b>	.20687	<b>.000</b>
	36-45	Më pak se 25	1.06207*	.37385	.026
		26-35	.36240	.19569	.253
		<b>Më shumë se 46</b>	<b>-.54033*</b>	.18972	<b>.025</b>
Më shumë se 46	Më pak se 25	1.60241*	.37982	.000	
	26-35	.90273*	.20687	.000	
	36-45	.54033*	.18972	.025	

AMN	Më pak se 25	26-35	-.50000	.39578	.588
		36-45	-.98413	.38649	.057
		<b>Më shumë se 46</b>	<b>-1.45918*</b>	.39266	<b>.002</b>
	26-35	Më pak se 25	.50000	.39578	.588
		36-45	-.48413	.20231	.083
		<b>Më shumë se 46</b>	<b>-.95918*</b>	.21386	<b>.000</b>
	36-45	Më pak se 25	.98413	.38649	.057
		26-35	.48413	.20231	.083
		Më shumë se 46	-.47506	.19614	.077
	Më shumë se 46	Më pak se 25	1.45918*	.39266	.002
		26-35	.95918*	.21386	.000
		36-45	.47506	.19614	.077

Dallim tjetër me rëndësi në lidhje me këtë faktor ekziston ndërmjet mësimdhënësve të moshës 26-35 vjeç me ata të moshës më shumë se 46 vjeç. Dallimi mesatar është  $-0,902$  dhe kjo vlerë tregon se mësimdhënësit e moshës 26-35 vjeç kanë pasur një efektivitet më të ulët të mësimin në distancë se mësimdhënësit e moshës më shumë se 46 vjeç. Dallimi i fundit dhe më i vogël në lidhje me këtë faktor është ndërmjet mësimdhënësve të moshës 36-45 vjeç me ata të moshës më shumë se 46 vjeç. Dallimi mesatar është  $-0,543$ . Ky dallim tregon se mësimdhënësit e moshës 36-45 vjeç kanë pasur një efektivitet më të ulët të mësimin në distancë në krahasim me mësimdhënësit e moshës mbi 46 vjeç. Mund të konkludojmë se mësimdhënësit më të vjetër kanë pasur një efektivitet më të lartë të mësimin në distancë sesa mësimdhënësit e rinj.

Me këtë rast, hipoteza  $H_4$ : Efektiviteti i mësimin në distancë dallon sipas moshës së mësimdhënësve **është pranuar me sukses**.

Kurse sa i përket faktorit të dytë, dallimi i parë ekziston ndërmjet mësimdhënësve të moshës nën 25 vjeç me mësimdhënësit e moshës mbi 46 vjeç. Dallimi mesatar është  $-1,459$  dhe ky dallim tregon se mësimdhënësit e rinj kanë pasur një angazhim më të ulët me nxënësit e tyre se mësimdhënësit e vjetër. Dallimi i dytë signifikant ekziston ndërmjet mësimdhënësit të moshës 26-35 vjeç me mësimdhënësit e moshës mbi 46 vjeç. Dallimi mesatar është  $-0,959$  dhe ngjashëm sikur mësipër, ky dallim tregon se mësimdhënësit e moshës 26-35 vjeç kanë pasur një angazhim më të ulët me nxënësit se mësimdhënësit e moshës mbi 46 vjeç. Pra, përsëri, mësimdhënësit më të vjetër shihet të jenë më të angazhuar me nxënësit e tyre se mësimdhënësit më të rinj. Në këtë

mënyrë, hipoteza H<sub>5</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës dallon sipas moshës së mësimdhënësve *është pranuar*.

Testimi i dallimeve sipas nivelit të edukimit të mësimdhënësve nuk është bërë sepse një gjë e tillë nuk është e logjikshme me supozimin se të gjithë mësimdhënësit kanë të përfunduar së paku nivelin Baçelor ose Shkollën e Lartë Pedagogjike. Prandaj, një testim i tillë nuk është parë i nevojshëm.

*H<sub>6</sub>: Efektiviteti i mësimi në distancë dallon sipas ciklit të arsimit të mësimdhënësve.*

*H<sub>7</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës dallon sipas ciklit të arsimit mësimdhënësve.*

Pas kësaj, është bërë testimi i dallimeve në efektivitetin e mësimi në distancë dhe angazhimit mësimdhënës-nxënës sipas ciklit të mësimi, mirëpo për shkak se shumica e mësimdhënësve kanë qenë në nivelin e arsimit fillor dhe arsimit të mesëm të ulët, testet Post-Hoc (të krahasimeve të shumëfishta) nuk janë kalkuluar dhe dallimet ndërmjet këtyre dy cikleve nuk kanë qenë signifikante sipas analizës One-Ëay ANOVA. Sa për ilustrim, ne kemi testuar dallimet sipas ciklit fillor dhe ciklit të mesëm të ulët me anë të testit t.

**Tabela 16:** Rezultatet e testit-t për dallimet në organizimin e mësimi në distancë sipas ciklit të arsimit të mësimdhënësve

	<b>Cikli i arsimit</b>	<b>N</b>	<b>Mesatarja</b>	<b>Devijimi Std.</b>	<b>F</b>	<b>Sig. (2-tail)</b>
<b>EMD</b>	Arsim fillor	94	3.006	1.157	3.832	.762
	Arsim i mesëm i ulët	68	2.953	.969		
<b>AMN</b>	Arsim fillor	2.050	2.050	.984	12.294	.079
	Arsim i mesëm i ulët	2.356	2.356	1.219		

Tabela 16 paraqet rezultatet e testit-t për dallimet në organizimin e mësimi në distancë sipas ciklit të arsimit. Në lidhje me faktorin e parë, EMD, vlera F=3,832 dhe Sig=0,762 tregojnë që nuk ekziston ndonjë dallim i rëndësishëm në këtë faktor sipas ciklit në të cilin janë të angazhuar mësimdhënësit. Në lidhje me faktorin e dytë, AMN, vlera F=12,294 dhe Sig=0,079, po ashtu, tregojnë që dallimi ndërmjet ciklit të mësimdhënësve nuk është signifikant. Siç mund të shihet,

mesataret e mësimdhënësve në ciklin e arsimit fillor dhe atë të mesëm të ulët nuk janë shumë të largëta nga njëra-tjetra.

Si përfundim, hipoteza H<sub>6</sub>: Efektiviteti i mësimin në distancë dallon sipas ciklit të arsimit të mësimdhënësve dhe hipoteza H<sub>7</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës dallon sipas ciklit të arsimit të mësimdhënësve *nuk janë pranuar*.

**H<sub>8</sub>: Efektiviteti i mësimin në distancë dallon sipas vendit të punës së mësimdhënësve.**

**H<sub>9</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës dallon sipas vendit të punës së mësimdhënësve..**

Duke qenë se janë hulumtuar edhe mësimdhënësit të cilët punojnë në fshat, edhe ata në qytet, është hulumtuar nëse ekziston ndonjë dallim ndërmjet tyre në lidhje me organizimin e mësimin në distancë. Ky dallim është testuar me testin-t.

**Tabela 17:** Rezultatet e testit-t për dallimet në organizimin e mësimin në distancë sipas vendit të punës të mësimdhënësve

	Vendi	N	Mesatarja	Devijimi Std.	F	Sig. (2-tail)
<b>EMD</b>	Fshat	85	3.099	.944	6.898	.159
	Qytet	79	2.862	1.190		
<b>AMN</b>	Fshat	85	2.364	1.164	3.388	.045
	Qytet	79	2.019	1.011		

Në fund, rezultatet e testit-t në lidhje me faktorin e parë, F=6,898 dhe Sig=0,159 tregojnë se nuk ekziston dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet mësimdhënësve sa i përket lokacionit, qoftë fshat apo qytet. Kjo është qartësisht e arsyeshme, sepse përkundër fshatit apo qytetit, mësimin është organizuar në distancë dhe kjo nuk ka penguar që nxënësit e fshatit të jenë më pak efektiv se ata të qytetit. Si rezultat, hipoteza H<sub>8</sub>: Efektiviteti i mësimin në distancë dallon sipas vendit të punës së mësimdhënësve *nuk është pranuar*.

Mirëpo, në lidhje me faktorin e dytë, vlera F=3,388 dhe Sig=0,045, kjo e fundit e cila tregon se është më e ulët se 5%, tregojnë se ekziston një dallim i rëndësishëm i angazhimit mësimdhënës-nxënës sipas lokacionit të mësimdhënësve. Mesatarja e mësimdhënësve në fshat për angazhimin mësimdhënës-nxënës është 2,364 dhe mesatarja e mësimdhënësve në qytet për angazhimin

mësimdhënës-nxënës është 2,019. Kjo tregon që mësimdhënësit e qytetit kanë një nivel pak më të lartë të angazhimit me nxënësit e tyre se mësimdhënësit e fshatit. Megjithatë, sado që ky dallim është signifikant, nuk është dallim ekstrem sepse mesataret gjenden në anën e deklaratave pozitive (1-plotësisht pajtohem, 2-pajtohem...). Si rezultat, hipoteza H<sub>9</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës dallon sipas vendit të mësimdhënësve *është pranuar*.

Duke qenë se të gjithë mësimdhënësit e përfshirë në analiza kanë qenë të angazhuar online dhe se të gjithë i kanë parë materialet e transmetuara në kanalën RTK1 ose RTK4, nuk mund të hulumtohet ndonjë dallim ndërmjet mësimdhënësve në këtë aspekt.



## ANALIZË E HULUMTIMIT ME PRINDËR

Të dhënat e mbledhura nga ky hulumtim janë analizuar me anë të programit SPSS.

### Të dhënat përshkruese

Në vazhdim janë paraqitur statistikat bazike në lidhje me të gjitha variablat e pyetësorit. Fillimisht janë paraqitur frekuencat dhe pastaj mesatarja dhe devijimi standard.

**Tabela 1:** Statistikat përshkruese në lidhje me mostrën (n=60)

Variablat		Frekuencat	Përqindja	Mesatarja	Devijimi Std.
Gjinia	Femër	53	88.3	1.116	.323
	Mashkull	7	11.7		
Moshë	Më pak se 25	2	3.3	2.250	.600
	26-35	44	73.3		
	36-45	11	18.3		
	Më shumë se 46	3	5.0		
Edukimi	Shkollë e mesme	40	66.7	1.700	1.013
	Bachelor	18	30.0		
	Master	2	3.3		
Punësimi	I punësuar	25	41.7	1.583	.497
	I papunësuar	35	58.3		
Angazhimi online	Po	60	100.0	1.000	.000
Shikimi i mater. Audiovizive	Po	60	100.0	1.000	.000

Tabela 1 jep statistikat përshkruese në lidhje me mostrën.

Në hulumtimin me prindër, kanë marrë pjesë 60 prindër, 53 prej të cilëve femra dhe 7 meshkuj. 3,3% e prindërve i përkasin moshës më pak se 25 vjeç, 73,3% i përkasin moshës 26-35 vjeç, 18,3% i përkasin moshës 36-45 vjeç dhe vetëm 5% i përkasin moshës më shumë se 46 vjeç. 66,7% e prindërve pjesëmarrës në hulumtim kanë të përfunduar shkollën e mesme, 30% e tyre kanë të përfunduar studimet baçelor dhe 3,3% e tyre kanë të përfunduar nivelin master. 41,7% e prindërve janë të punësuar, kurse 58,3% e tyre janë të papunë.

Të gjithë prindërit pjesëmarrës kanë qenë të angazhuar në mësimet online me fëmijët e tyre dhe të gjithë prindërit i kanë shikuar materialet audioviive të transmetuara në kanalin televiziv RTK1 dhe RTK4.

Ngjashëm sikurse me hulumtimin me mësimdhënësit, edhe për hulumtimin me prindërit, krahas shpërndarjes së frekuencave dhe përqindjeve janë paraqit mesatarja dhe devijimi standard për secilën nga këto pyetje nominale.

**Tabela 2:** Shpërndarja e përgjigjeve të dhëna ndaj pyetjeve në lidhje me organizimin e mësimit në distancë

	Pajtohem plotësisht		Pajtohem		Neutral		Nuk pajtohem		Nuk pajtohem fare	
	F	%	F	%	F	%	F	%	F	%
A pajtoheni se ju si prind e mbështetni fëmijun në mësimin në kushtet e shtëpisë?	31	51.7	18	30.0	1	1.7	6	10.0	4	6.7
A pajtoheni se të mësuarit në distancë ka të njëjtën cilësi si procesi mësimor në klasë?	13	21.7	8	13.3	6	10.0	8	13.3	25	41.7
A pajtoheni se fëmija juaj angazhohet maksimalisht për kryerjen e detyrave të dhëna nga mësuesit e tij?	18	30.0	19	31.7	6	10.0	6	10.0	11	18.3
A pajtoheni se fëmija juaj mund të bëjë pyetje për mësuesin e tij dhe të marrë një përgjigje të shpejtë gjatë aktiviteteve mësimore?	22	36.7	23	38.3	4	6.7	6	10.0	5	8.3
A pajtoheni se fëmija juaj jo vetëm që ka përsëritur njohuritë e fituara më parë, por edhe ka përvetësuar njohuri të reja?	13	21.7	12	20.0	6	10.0	10	16.7	19	31.7
A pajtoheni se gjatë mësimit në distancë, fëmija juaj merr vlerësime ose komente nga mësuesit për detyrat ose ushtrimet që kryhen?	20	33.3	17	28.3	5	8.3	7	11.7	11	18.3
A pajtoheni se mësimi efektiv mund të zhvillohet edhe pa ndërvepruar mësuesi me nxënësit ballë për ballë?	11	18.3	12	20.0	5	8.3	12	20.0	20	33.3

A pajtoheni se të mësuarit në mënyrë elektronike ndikon në zhvillimin personal dhe social të fëmijës sim?	17	28.3	15	25.0	11	18.3	8	13.3	9	15.0
A pajtoheni se fëmija juaj punon në grup gjatë aktiviteteve të mësimit online?	13	21.7	9	15.0	7	11.7	8	13.3	23	38.3

Pas shpërndarjes së frekuencave dhe përqindjeve për të dhënat demografike të prindërve, në Tabelën 2 kemi paraqitur shpërndarjet e përgjigjeve për nëntë pyetjet të cilat masin organizimin e mësimit në distancë. Ngjashëm sikurse te hulumtimi me mësime të ndryshme, edhe në këtë tabelë nuk do të bëjmë ndonjë interpretim, pasi shpërndarjet e përgjigjeve janë të ndryshme dhe se konkluzionet tona do t'i nxjerrim pas analizës faktoriale. Megjithatë, mund të shohim se prindërit janë pajtuar më shumë me disa pyetje, e më pak me pyetje të tjera.

**Tabela 3:** Statistikat përshkruese në lidhje me pyetjet që masin organizimin e mësimit në distancë

	<b>Vlera minimale</b>	<b>Vlera maksimale</b>	<b>Mesatarja</b>	<b>Devijimi Std.</b>
A pajtoheni se ju si prind e mbështetni fëmijun në mësimin në kushtet e shtëpisë?	1.00	5.00	1.9000	1.24465
A pajtoheni se të mësuarit në distancë ka të njëjtën cilësi si procesi mësimor në klasë?	1.00	5.00	3.4000	1.63852
A pajtoheni se fëmija juaj angazhohet maksimalisht për kryerjen e detyrave të dhëna nga mësuesit e tij?	1.00	5.00	2.5500	1.47780
A pajtoheni se fëmija juaj mund të bëjë pyetje për mësuesin e tij dhe të marrë një përgjigje të shpejtë gjatë aktivitetëve mësimore?	1.00	5.00	2.1500	1.25988
A pajtoheni se fëmija juaj jo vetëm që ka përsëritur njohuritë e fituara më parë, por edhe ka përvetësuar njohuri të reja?	1.00	5.00	3.1667	1.58560
A pajtoheni se gjatë mësimit në distancë, fëmija juaj merr vlerësime ose komente nga mësuesit për detyrat ose ushtrimet që kryhen?	1.00	5.00	2.5333	1.51228
A pajtoheni se mësimi efektiv mund të zhvillohet edhe pa ndërvepruar mësuesi me nxënësit ballë për ballë?	1.00	5.00	3.3000	1.55465
A pajtoheni se të mësuarit në mënyrë elektronike ndikon në zhvillimin personal dhe social të fëmijës sim?	1.00	5.00	2.6167	1.41531
A pajtoheni se fëmija juaj punon në grup gjatë aktivitetëve të mësimit online?	1.00	5.00	3.3167	1.62075

Tabela 3 përmbledh statistikat kryesore në lidhje me pyetjet bazë të hulumtimit, të matura me shkallë të Likertit. Me radhë janë paraqitur vlera minimale, vlera maksimale, mesatarja dhe devijimi standard. Vlera minimale prej 1 për të gjitha pyetjet nënkupton që secila pyetje të paktën është përzgjedhur njëherë për alternativën 1 të përgjigjes (1-plotësisht pajtohem), kurse vlera maksimale 5 për të gjitha pyetjet nënkupton që secila pyetje, të paktën është përzgjedhur njëherë nga një prindër pjesëmarrës (5-aspak nuk pajtohem). Mesatarja paraqet vlerën e saj për secilën pyetje si rezultat i mbledhjes së të gjitha përgjigjeve pjesëtuar me numrin pjesëmarrës të prindërve.

Në të njëjtën kohë, mesatarja për secilën pyetje reflekton pajtueshmërinë e prindërve pjesëmarrës në lidhje me këto pyetje dhe një mesatare më e ulët nënkupton se prindërit janë pajtuar më shumë me ato pyetje (1-plotësisht pajtohem, 2-pajtohem), kurse një mesatare më e lartë nënkupton se prindërit janë pajtuar më pak me ato pyetje (4-nuk pajtohem, 5-aspak nuk pajtohem). Pas mesatares, është paraqitur edhe devijimi standard për secilën pyetje.

## **VLEFSHMËRIA DHE BESUESHMËRIA E MATËSIT QË MAT PËRCEPTIMET E PRINDËRVE NË LIDHJE ME ORGANIZIMIN E MËSIMIT NË DISTANCË**

### **Vlefshmëria e Matësit**

Për të testuar vlefshmërinë e matësit, të përbërë prej nëntë pyetjeve, është përdorur analiza faktoriale eksploruese.

**Tabela 4:** Testi KMO dhe testi Barlett

Kaiser-Meyer-Olkin Measure of Sampling Adequacy.		.853
Bartlett's Test of Sphericity	Approx. Chi-Square	491.810
	Df	36
	Sig.	.000

Tabela 4 paraqet rezultatet e testeve të para të analizës faktoriale. Testi KMO dhe testi Barlett tregojnë nëse seti i të dhënave është i përshtatshëm për të kryer analizën faktoriale. Vlera 0,853 e testit KMO dhe vlera Sig 0,000 e testit Barlett konfirmojnë se seti i të dhënave të këtij hulumtimi është shumë i përshtatshëm për performimin e analizës faktoriale.

**Tabela 5:** Varianca totale e shpjeguar

Komponentët	Vlera fillestare Eigen			Shumat e rrotulluara të ngarkesave në katrorë		
	Total	% e variancës	% kumulative	Total	% e variancës	% kumulative
1	5.975	66.383	66.383	3.760	41.774	41.774
2	1.141	12.683	79.067	3.356	37.293	79.067
3	.625	6.948	86.015			
4	.377	4.188	90.203			
5	.310	3.448	93.652			
6	.213	2.361	96.013			
7	.198	2.201	98.213			

8	.088	.983	99.196			
9	.072	.804	100.000			

Në tabelën 5 janë dhënë informacionet në lidhje me variancën totale të shpjeguar. Vlera Eigen tregon se nga nëntë pyetjet e futuara në analizën faktoriale, janë formuar dy faktorë të cilët e kanë vlerën Eigen më të madhe se 1. Faktori i parë shpjegon 41,774% të variancës totale, kurse faktori i dytë shpjegon 37,293% të variancës totale. Bashkarisht, këta dy faktorë shpjegojnë 79,067% të variancës totale. Kjo vlerë është shumë e lartë dhe tregon për vlefshmërinë e këtij matësi. Me fjalë të tjera, nëntë pyetjet e përdorura për të matur perceptimet e prindërve në lidhje me organizimin e mësimit në distancë masin përfaqësojnë 80% me sukses këtë temë.

**Tabela 6:** Matrica e rrotulluar e komponentëve

	Komponentët	
	1	2
A pajtoheni se fëmija juaj jo vetëm që ka përsëritur njohuritë e fituara më parë, por edhe ka përvetësuar njohuri të reja?	.887	
A pajtoheni se mësimi efektiv mund të zhvillohet edhe pa ndërvepruar mësuesi me nxënësit ballë për ballë?	.886	
A pajtoheni se të mësuarit në distancë ka të njëjtën cilësi si procesi mësimor në klasë?	.846	
A pajtoheni se fëmija juaj punon në grup gjatë aktiviteteve të mësimit online?	.802	
A pajtoheni se fëmija juaj mund të bëjë pyetje për mësuesin e tij dhe të marrë një përgjigje të shpejtë gjatë aktiviteteve mësimore?		.890
A pajtoheni se ju si prind e mbështetni fëmijun në mësimin në kushtet e shtëpisë?		.876
A pajtoheni se të mësuarit në mënyrë elektronike ndikon në zhvillimin personal dhe social të fëmijës sim?		.717
A pajtoheni se gjatë mësimit në distancë, fëmija juaj merr vlerësime ose komente nga mësuesit për detyrat ose ushtrimet që kryhen?		.696
A pajtoheni se fëmija juaj angazhohet maksimalisht për kryerjen e detyrave të dhëna nga mësuesit e tij?		.667

Extraction Method: Principal Component Analysis.

Rotation Method: Varimax ëith Kaiser Normalization.

Në fund, tabela 6 përmbledh rezultatet përfundimtare të analizës faktoriale. Sikurse u sqarua te tabela e variancës së shpjeguar, kanë rezultuar dy faktorë nga nëntë pyetjet që masin përceptimet e prindërve në lidhje me organizimin e mësimit në distancë. Faktori i parë ka katër pyetje, kurse faktori i dytë ka pesë pyetje. Të gjitha pyetjet kanë ngarkesë pozitive dhe më të madhe se 0,50, prandaj nuk ka nevojë për largimin e ndonjë pyetjeje nga matësi.

Katër pyetjet e faktorit të parë kanë të bëjnë me përceptimin e prindërve në lidhje me efektivitetin e mësimit në distancë, prandaj ky faktor do të emërohet si “përceptimi i prindërve në lidhje me **efektivitetin e mësimit në distancë (EMD)**”, që për arsye lehtësimi, në vazhdim ky faktor do të referohet si EMD, duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me përceptimet e prindërve.

Pesë pyetjet e faktorit të dytë masin përceptimet e prindërve në lidhje me angazhimin e fëmijëve të tyre me mësimit dhe detyrat e tjera të organizuara në distancë. Prandaj, këtë faktor mund ta emërojmë si “përceptimet e prindërve në lidhje me angazhimin e fëmijëve për mësimin në distancë”, shkurtimisht referuar si **angazhimi në mësimin në distancë (AMD)**.

### **Besueshmëria e Matësit**

Sigurisht se në çdo hulumtim të mirëfilltë, krahas vlefshmërisë së matësit duhet të testohet edhe besueshmëria e matësit, sepse një matës mund të jetë i vlefshëm, por mund të mos jetë i besueshëm dhe anasjelltas, një matës mund të jetë i besueshëm, por të mos jetë i vlefshëm. Një matës i vlefshëm, por i pabesueshëm është i pavlefshëm, prandaj në një hulumtim duhet të shqyrtohen edhe vlefshmëria, edhe besueshmëria e matësit.

**Tabela 7:** Besueshmëria e matësit që mat përceptimet e prindërve në lidhje me organizimin e mësimit në distancë

	<b>Cronbach’s Alpha</b>	<b>Numri i pyetjeve</b>
Besueshmëria e përgjithshme	.935	9
EMD	.929	4
AMD	.906	5

Tabela 7 paraqet rezultatet e analizës së besueshmërisë. Besueshmëria e përgjithshme e matësit kur janë përfshirë të gjitha pyetjet është 0,935. Kjo vlerë e koeficientit Cronbach’s Alpha tregon që besueshmëria e përgjithshme e matësit është shumë e lartë. Në të njëjtën mënyrë, koeficienti i



besueshmërisë për faktorin EMD dhe për faktorin AMD është 0,929 dhe 0,906 respektivisht. Këto vlera janë mjaft të larta dhe tregojnë që të dy faktorët e formuar nga analiza faktoriale kanë shkallë shumë të lartë të besueshmërisë.

### Analiza e Korrelacionit

**Tabela 8:** Analiza e korrelacionit ndërmjet variablave

	<b>EMD</b>	<b>AMD</b>	<b>gjinia</b>	<b>mosha</b>	<b>edukimi</b>	<b>punësimi</b>
EMD	1					
AMD	<b>.710**</b>	1				
Gjinia	.097	-.002	1			
Mosha	.084	.080	<b>.371**</b>	1		
edukimi	<b>-.342**</b>	<b>-.358**</b>	.057	.181	1	
punësimi	<b>.303*</b>	<b>.293*</b>	<b>-.325*</b>	-.213	<b>-.622**</b>	1

\*\* . Korrelacioni është signifikant në nivelin 0.01 (2-tailed).\* . Korrelacioni është signifikant në nivelin 0.05 (2-tailed).

Pas analizës së besueshmërisë, kemi performuar analizën e korrelacionit ndërmjet faktorëve me variablat demografike. Fillimisht, mund të vërehet se ekziston një korrelacion i lartë dhe pozitiv ndërmjet faktorit EMD dhe AMD ( $r=0,710$ ,  $p<0,01$ ). Faktori EMD po ashtu ka një korrelacion signifikant, por negativ me edukimin ( $r=-0,342$ ,  $p<0,01$ ) dhe pozitiv me punësimin e prindërve ( $r=0,303$ ,  $p<0,05$ ). Faktori AMD ka një korrelacion negativ me edukimin ( $r=-0,358$ ,  $p<0,01$ ) dhe një korrelacion pozitiv me punësimin ( $r=0,293$ ,  $p<0,05$ ). Përveç kësaj, korrelacione pozitiv ekzistojnë ndërmjet gjinisë dhe moshës, gjinisë dhe punësimit, edukimit dhe punësimit.

### Analiza e Regresionit

Duke qenë se analiza faktoriale rezultoi në dy faktorë të rëndësishëm, faktori i angazhimit të fëmijëve në mësimin në distancë (AMD), gjithmonë duke pasur parasysh perceptimin e prindërve, ka natyrë të variablës së pavarur, kurse faktori i efektivitetit të mësimin në distancë (EMD), ka natyrë të varur, e cila shkaktohet nga AMD-ja. Prandaj, duke përdorur analizën e regresionit të thjeshtë linear, ne kemi testuar për efektin e angazhimit të fëmijëve me mësimin në distancë në efektivitetin e mësimin në distancë.

**H<sub>1</sub>: Angazhimi me mësimin në distancë ka një efekt të rëndësishëm në efektivitetin e mësimin në distancë.**

**Tabela 9:** Rezultatet e analizës së regresionit

Variabla e varur	Variabla e pavarur	$\beta$	T	P	F	Modeli (p)	R	R <sup>2</sup>
EMD	Konstantja	1.246	4.181	.000	59.079	.000	.710	.505
	AMD	.872	7.686	.000				

Në tabelën 9 janë përmbledhur rezultatet e analizës së regresionit linear. Vlera R<sup>2</sup> prej 0,505 tregon që 50,5% e ndryshimit në variablën e varur shpjegohet nga ndryshimi në variablën e pavarur. Me fjalë të tjera, angazhimi i nxënësve me mësimin në distancë ndikon 50,5% në efektivitetin e mësimin në distancë, gjithmonë sipas perceptimeve të prindërve. Kjo vlerë është vlerë e pranuar dhe modeli i regresionit është signifikant (F=59,079, p<0,01). Në mënyrë të ngjashme, koeficienti Beta  $\beta=0,872$ , p<0,01, tregon që AMD-ja ka një efekt prej 87,2% në EMD-në. Në këtë mënyrë, ne mund të **pranojmë hipotezën e parë** për hulumtimin me prindërit.

### **Hulumtimi i Dallimeve të Faktorëve Sipas Karakteristikave Demografike të Prindërve**

#### **Testimi i dallimeve sipas gjinisë së prindërve**

**Tabela 10:** Rezultatet e testit t në lidhje me dallimet në faktorët e mësimin në distancë sipas gjinisë së prindërve

	Gjinia	Mesatarja	Devijimi Standard	F	Sig
EMD	Femër	3.2453	1.46800	.253	.463
	Mashkull	3.6786	1.36713		
AMD	Femër	2.3509	1.22154	1.639	.987
	Mashkull	2.3429	.90711		

Tabela 10 paraqet rezultatet e testit-t të pavarur në lidhje me dallimet sipas gjinisë së prindërve, sa i përket faktorëve të përfituara nga analiza faktoriale. Vlerat F=0,253 dhe Sig=0,463 dhe F=1,639 dhe Sig=0,987 tregojnë që nuk ekzistojnë dallime signifikante sipas gjinisë së prindërve sa i përket perceptimeve të tyre në lidhje me organizimin e mësimin në distancë. Siç mund të vërehet, mesataret e prindërve femra dhe prindërve meshkuj janë të përafërta për të dy faktorët.

## Testimi i dallimeve sipas moshës së prindërve

**Tabela 11:** Rezultatet e analizës One-Ëay Anova në lidhje me dallimet sipas moshës së prindërve

		<b>Shuma e katrorëve</b>	<b>Df</b>	<b>Katrori mesatar</b>	<b>F</b>	<b>Sig.</b>
EMD	Ndërmjet grupeve	1.959	3	.653	.299	.826
	Brenda grupeve	122.478	56	2.187		
	Total	124.436	59			
AMD	Ndërmjet grupeve	2.265	3	.755	.527	.666
	Brenda grupeve	80.265	56	1.433		
	Total	82.530	59			

Në vazhdim, kemi testuar dallimet e faktorëve sipas moshës së prindërve. Tabela 10 përmbledh rezultatet e analizës One-Way ANOVA. Vlerat  $F=0,299$  dhe  $Sig=0,826$  për faktorin EMD dhe vlerat  $F=0,527$  dhe  $Sig=0,666$  për faktorin AMD tregojnë se nuk ekzistojnë dallime signifikante në këta dy faktorë sipas moshës së prindërve. Me fjalë të tjera, perceptimet e prindërve në lidhje me organizimin e mësimin në distancë nuk ndryshojnë sipas moshës së prindërve.

Këto rezultate kuptohen edhe nga tabela e krahasimeve të shumëfishta, në Tabelën 11, ku duke përdorur testin Tukey nga testet post-hoc, mund të shohim se dallimet mesatare ndërmjet prindërve sipas grupmoshave nuk janë signifikante.

**Tabela 12:** Rezultatet e krahasimeve të shumëfishta për dallimet sipas moshës

<b>Variabla e varur</b>	<b>(I) mosha</b>	<b>(J) mosha</b>	<b>Dallimi mesatar (I-J)</b>	<b>Gabimi Std.</b>	<b>Sig.</b>
EMD	Më pak se 25	26-35	-.00568	1.06923	1.000
		36-45	.00000	1.13683	1.000
		Më shumë se 46	-.83333	1.35003	.926
	26-35	Më pak se 25	.00568	1.06923	1.000
		36-45	.00568	.49853	1.000
		Më shumë se 46	-.82765	.88246	.785
	36-45	Më pak se 25	.00000	1.13683	1.000
		26-35	-.00568	.49853	1.000
		Më shumë se 46	-.83333	.96326	.823
	Më shumë se 46	Më pak se 25	.83333	1.35003	.926
		26-35	.82765	.88246	.785
		36-45	.83333	.96326	.823

AMD	Më pak se 25	26-35	-.46364	.86558	.950
		36-45	-.28182	.92030	.990
		Më shumë se 46	-1.16667	1.09289	.711
	26-35	Më pak se 25	.46364	.86558	.950
		36-45	.18182	.40358	.969
		Më shumë se 46	-.70303	.71438	.759
	36-45	Më pak se 25	.28182	.92030	.990
		26-35	-.18182	.40358	.969
		Më shumë se 46	-.88485	.77979	.670
	Më shumë se 46	Më pak se 25	1.16667	1.09289	.711
		26-35	.70303	.71438	.759
		36-45	.88485	.77979	.670

### **Testimi i dallimeve sipas edukimit të prindërve**

**Tabela 13:** Rezultatet e analizës One-Ëay Anova në lidhje me dallimet sipas edukimit të prindërve

		<b>Shuma e katrorëve</b>	<b>Df</b>	<b>Katrori mesatar</b>	<b>F</b>	<b>Sig.</b>
EMD	Ndërmjet grupeve	16.836	2	8.418	4.459	.016
	Brenda grupeve	107.600	57	1.888		
	Total	124.436	59			
AMD	Ndërmjet grupeve	10.583	2	5.291	4.192	.020
	Brenda grupeve	71.947	57	1.262		
	Total	82.530	59			

Në lidhje me dallimet në faktorët e organizimit të mësimin në distancë, rezultatet nga Tabela 12 tregojnë se ekzistojnë dallime në përceptimet e prindërve për të dy faktorët. Vlera F dhe Sig për faktorin EMD janë 4,459 dhe 0,016, respektivisht. Vlera F dhe Sig për faktorin AMD janë 4,192 dhe 0,020, respektivisht.

**Tabela 14:** Rezultatet e krahasimeve të shumëfishta për dallimet sipas edukimit

Variabla e varur	(I) edukimi	(J) edukimi	Dallimi mesatar (I-J)	Gabimi Std.	Sig.
EMD	Shkollë e mesme	Bachelor	<b>1.16250*</b>	.38996	<b>.012</b>
		Master	.53750	.99552	.852
	Bachelor	Shkollë e mesme	-1.16250*	.38996	.012
		Master	-.62500	1.02408	.815
	Master	Shkollë e mesme	-.53750	.99552	.852
		Bachelor	.62500	1.02408	.815
AMD	Shkollë e mesme	Bachelor	<b>.81778*</b>	.31887	<b>.034</b>
		Master	1.34000	.81405	.235
	Bachelor	Shkollë e mesme	-.81778*	.31887	.034
		Master	.52222	.83740	.808
	Master	Shkollë e mesme	-1.34000	.81405	.235
		Bachelor	-.52222	.83740	.808

Dallimet ndërmjet prindërve sipas nivelit të edukimit janë testuar me anë të testit Tukey, si testi më i përdorur nga testet post-hoc. Sa i përket faktorit EMD, ekzistojnë dallime signifikante ndërmjet prindërve me shkollë të mesme dhe atyre me bachelor. Dallimi mesatar është 1,16250 dhe ky dallim tregon se prindërit me shkollë të mesme kanë një përceptim më të lartë të efektivitetit të mësimit në distancë të fëmijëve të tyre, sesa ata me bachelor. Pra, prindërit me bachelor, mendojnë se efektiviteti i mësimit në distancë nuk është në nivelin e duhur, në krahasim me prindërit me shkollë të mesme.

Dallim i ngjashëm ekziston edhe për faktorin e dytë, AMD. Ekziston dallim ndërmjet prindërve me shkollë të mesme dhe prindërve me nivelin bachelor. Dallimi mesatar është 0,81778 dhe kjo vlerë tregon se prindërit me shkollë të mesme mendojnë se fëmijët e tyre angazhohen mjaftueshëm në mësimin në distancë në krahasim me prindërit me bachelor, të cilët kanë një mesatare negative. Duke u mbështetur në këto të dhëna, mund të konkludojmë se ekziston një dallim në përceptimet e prindërve në lidhje me organizimin e mësimit në distancë sipas nivelit të edukimit të tyre.

## **Testimi i dallimeve sipas statusit të punësimit të prindërve**

**Tabela 15:** Rezultatet e testit t në lidhje me dallimet në faktorët e mësimin në distancë sipas statusit të punësimit të prindërve

	<b>Punësimi</b>	<b>Mesatarja</b>	<b>Devijimi Standard</b>	<b>F</b>	<b>Sig</b>
EMD	I punësuar	2.7800	1.48661	.618	.019
	I papunësuar	3.6643	1.32834		
AMD	I punësuar	1.9440	1.12030	.125	.023
	I papunësuar	2.6400	1.15484		

Hipotezën e fundit e kemi testuar me anë të testit-t të pavarur. Në lidhje me faktorin e parë, Vlera  $F=0,618$  dhe  $Sig=0,019$  tregojnë se ekziston një dallim në këtë faktor sipas statusit të punësimit të prindërve. Mesatarja e prindërve të punësuar është 2,78, kurse mesatarja e prindërve të papunësuar është 3,66. Kjo tregon se prindërit e punësuar kanë perceptime për efektivitet më të lartë të mësimin në distancë (1=plotësisht pajtohem, 2-pajtohem, ...) sesa prindërit e papunësuar, mesatarja e të cilëve është duke anuar nga deklarat negative (3-neutral, 4-nuk pajtohem). Në mënyrë të ngjashme, vlera  $F=0,125$  dhe  $Sig=0,023$  tregojnë se ekziston një dallim i rëndësishëm në faktorin e angazhimit me mësimin në distancë ndërmjet prindërve të punësuar dhe atyre të papunësuar. Përsëri, mesatarja e prindërve të punësuar prej 1,94 është më e ulët (1=plotësisht pajtohem) se mesatarja e prindërve të papunësuar prej 2,64, që tregon se prindërit e punësuar kanë një nivel perceptimi për një angazhim më të lartë të fëmijëve të tyre me mësimin në distancë, sesa prindërit e papunësuar. Në këtë mënyrë, dy hipotezat e fundit të këtij hulumtimi pranohen me sukses.

## **ANALIZË E PYETËSOREVE ME DREJTORËT**

Në mënyrë që të fitojmë më shumë rreth perceptimeve dhe mendimeve të drejtorëve për mësimin në distancë më e përshatshme ka qënë realizimi i hulumtimit kualitativ dhe si instrument i këtij hulumtimi është përdorur intervista.

### ***Mbledhja e të dhënave***

Nga të gjitha komunat e Kosovës janë përzgjedhur vetëm tri komuna që të realizohen intervistat: Istog, Pejë dhe Prishtinë, kjo për arsye të kohës dhe kostos së lartë.

Pyetësi është i hartuar nga 6 pyetje dhe disa nënpyetje të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me organizimin e mësimin në distancë. Pyetjet janë hartuar në bazë të shfletimit të literaturave të ndryshme dhe punimeve shkencore

### ***Mostra***

Në hulumtim kanë marrë pjesë gjithsej 10 drejtor te shkollave të mesme nga tri komunat e Kosovës: Istog, Pejë dhe Prishtinë.

### ***Gjetjet: Perceptimet e drejtorëve për organizimin e mësimin në distancë***

Të gjitha intervistat janë lexuar dhe rilexuar në mënyrë që të kuptojmë sa më shumë nga perceptimet e drejtorëve.

Në pyetjen e parë të parashtruar të gjithë drejtorët kanë përvojë pune më shumë se 10 vite, dhe të gjithë kanë të përfunduar studimet baçelor.

Pyetja e dytë ishte se sa kanë qënë të angazhuar drejtorët në ecurinë e organizimit në distancë, dhe përgjigjet e tyre korrsodojnë se angazhimi i tyre nuk ka munguar, dhe se punën e kanë kryer me përgjegjshmeri të lartë.

*Nga marsi i vitit të kaluar (2020), mësimdhënësit kanë filluar të përdorin platforma të ndryshme për mësimin online. Nga pozita e drejtorit të shkollës ishte e pashmangshme pjesëmarrja aktive në këtë proces. Prandaj, shumicën e aktivizimit të mësimdhënësve dhe nxënësve i kam përcjellë me përkushtim dhe përgjegjësi.(dr3)*

*Ecuria e organizimit të mësimin në distancë nuk do të ishte e mundur pa angazhimin maksimal të drejtorëve,prandaj angazhimi im ka qenë i madh si drejtoreshë e kësaj shkolle. (dr5)*

Në pyetjet pasuese se sa jeni të kënaqur me punën dhe angazhimin e mësimdhënësve për mësimin në distancë,të gjithë shumica e drejtorëve pohojnë se janë kryesisht të kënaqur ,duke i potencuar edhe vështirësitë, por megjithatë janë të kënaqur me punën dhe angazhimin e mësimdhënësve në këtë process.

*Mësimdhënësit kanë qenë të angazhuar përqindja më e lartë e tyre,ndonëse kishte nga ata që kanë hezitur dhe nuk e kanë përkrahur këtë formë të re të mësimdhënies (dr4)*

*Mësimdhënësit kanë qenë jashtëzakonisht të angazhuar në këtë process, nga të cilët nuk ka munguar puna dhe përkushtimi në asnjë moment (dr7)*

*Të gjithë mësimdhënësit janë angazhuar në këtë proces. Duhet cekur se jo të gjithë kanë qenë të suksesshëm në zhvillimin e mësimin online. Kjo për shkaqe subjektive të mësimdhënësve (përgatitja profesionale në përdorimin e mjeteve digjitale), edhe pse me kalimin e kohës, numri më i madh i tyre ka arritur t'i përforcojë shkathtësitë e përdorimit të mjeteve digjitale. Megjithatë, për shkaqe objektive, mësimdhënësit nuk kanë pasur mundësi të japin më të mirën e tyre. (dr1)*

Ndërsa në pyetjen se sa kanë bashkëpunuar drejtoret me mësimdhënësit, të gjithë pjesëmarrësit kanë pohuar se kanë qenë maksimalisht në bashkëpunim me mësimdhënësit.

*Në vazhdimësi kam qenë në kontakt me mësimdhënësit dhe kemi biseduar për organizimin dhe realizimin e mësimin online, me ç`rast jam përballë më vështirësitë e tyre për këtë lloj mësimi dhe përball mundësive kam dhënë kontributin tim qoftë si drejtor, kolegë apo njerëzor. Shpesh herë kam marrë pjesë në orët e mësimdhënësve të mbajtura përmes platformave të ndryshme. Më pas jemi konsultuar për evitimin e mangësive të identifikuara dhe kemi përkrahë anët e forta me qëllim të ndarjes me të tjerët. (dr10)*



*Bashkëpunimi është tejet i madh, si nga ana ime si nga ana e mësimit në distancë (dr1)*

Mendimi i përbashkët i të gjithë drejtorëve ishte se të gjithë kanë qenë motivues për mësimit në distancë qoftë në një formë apo mënyrë, duke kontribuar vazhdimisht ndaj mësimit në distancë dhe organizimit të mësimit në distancë.

*Vetë krenaria e të qenit mësimit në distancë është motivi kryesor. Bisedat e zhvilluara mes mësimit në distancë, nxënësve, prindërve dhe punëdhënësit (DKA) shtojnë interesin për një angazhim më të madh dhe më cilësor. (dr3)*

*Motivimi im ndaj mësimit në distancë nuk ka munguar asnjëherë, ku kam shprehur gatishmëri në çdo kohë dhe orar të ju dal në ndihmë mësimit në distancë që kishin vështirësi qoftë në organizim të mësimit apo çfarëdo pengese që ata kishin (dr9)*

*Motivimi im ndaj mësimit në distancë, nxënësve dhe prindërve ka qenë në nivel shumë të lartë dhe vazhdon të jetë, jo vetëm duke i motivuar por edhe duke i përkrahur në të gjitha aspektet e mundshme që janë pjesë e mësimit (dr6)*

Në pyetjen se cilët janë faktorët që e ndihmojnë organizimin e mësimit në distancë, përgjigjet ishin pothuajse të përafërta nga të gjithë drejtorët, duke i listuar si më të rëndësishmet infrastrukturën, rrjetin e gjerë, paisjet teknologjike, integrimin e teknologjisë, etj.

*Mbështetja e mësimit në distancë me platforma të njësuara nga MASHTI ose Kuvendi Komunal, përkrahja e tyre nga prindërit dhe punëdhënësit, infrastruktura e përmirësuar në institucionet shkollore (kabineti i TIK-ut me pajisje përcjellëse) dhe kontrolli i jashtëm profesional. (dr1)*

*Faktoret që e ndihmojnë mësimit në distancë përshtatshmeria e mësimit në distancë me paisje teknologjike, integrimi i teknologjisë në mësimit, organizimi i mësimit i kohës së mësimit (dr2)*

*Zhvillim të programeve edukativo-arsimore online, krijimi i programeve arsimore të përshtatshme dhe të bazuara në nevojat individuale të nxënësve, mbështetja e mirëqenies dhe shëndetit mendor, dhe ngritja e nivelit të mbështetjes për familjet, mësimit në distancë dhe kujdestarët konsiderohet e domosdoshme (dr5)*

Ndërsa sa i përkëtë faktorëve që e kanë penguar mësimin në distancë përgjigjet e drejtoreshave ishin të bazuara mbi mungesën e paisjeve teknologjike ,njohuri të pakta mbi përdorimin e internetit etj.

*Mungesa e paisjeve teknologjike qoftë nga nxënësit poashtu edhe nga mësuesit, shkathtësi dhe njohuri të pakta në përdorimin e drejtë të paisjeve teknologjike, mos gjeturi në këtë ecure të mësimin, mungesa e literaturës në mënyrë elektronike etj.(dr7)*

*Mungesa e paisjeve teknologjike sic janë lloptopet apo telefonat e mençur, njohuritë e pakta në shfrytëzimin e paisjeve teknologjike, mos kyçja në mësim shkak i rrymës elektrike apo mungesës së internetit. (dr6)*

*Mospërshtatshmeria e mësuesve me paisje teknologjike, niveli jo i mjaftueshëm i shkathtësive dhe njohurive për përdorimin e teknologjisë, të shoqëruara me mungesën e udhëzimeve të qarta për të vënë në funksion mësimin në online (dr10)*

Sfidat të cilat drejtoret kosovare i shohin shumë të rëndësishme për organizimin e mësimin në distancë janë mos pasisja e shkollave me laptop, pasisje me mjete digjitale, mungesa e trajnimeve me fokus të teknologjisë dhe integritit të saj.

*Pajisja e shkollave me rrjet të gjerë, laptop; pajisja e mësuesve me laptop, si dhe pajisja e nxënësve me mjete digjitale do e ndihmonin realizimin e mësimin online në një masë të shtuar, krahasuar me situatën aktuale e cila nuk është në nivelin e dëshiruar.(dr3)*

*Mospërshtatja e mësuesve në ecurinë e re të organizimit të mësimin në distancë , hezitimi i tyre që të kenë përvojë të re në këtë aspekt, mos përshtatshmeria me pasisje teknologjike dhe njohuritë e shkathtësitë e pakta në përdorimin e drejtë të pasisjeve teknologjike, mungesat e nxënësve në pjesmarrjen e mësimin për shkak të problemeve teknike apo mungesave të pasisjeve teknologjike për shkak të numrit të madh të fëmijëve në familje etj. (dr8)*

*Mungesa e paisjeve teknologjike, shfrytëzimi dhe njohuritë e pakta rreth tyre, mungesa e trajnimeve me fokus të teknologjisë dhe integritit të saj në mësim, mos marrja seriozisht e nxënësve për mësimin në kushte të shtëpisë . (dr9)*

Rekomandimet e drejtorëve të shkollave të mësme të ulëta për mbarvajtjen e procesit të organizimit të mësimin në distancë ishin që shkollat të jenë të paisura me paisje teknologjike ,të involvohet sa më shumë teknologjia në mësim, mbajtje e trajnimeve efikase me qëllim të përmirësimit të organizimit të mësimin në distancë.

*Rekomandimet e mia janë që mesimdhënësit të shohin mesimdhënien si proces të transferimit të informacioneve, ose përdorin qasjen me mesimdhënësin në qendër, në kuadër të së cilës mesimdhënësi komunikon informacionet tek nxënësit dhe përdor teknika të ndryshme të vlerësimit për të vlerësuar memorizimin e të dhënave, apo nëse janë mesimdhënës të cilët shohin të nxënësit si proces përmes të të cilit arrihen ndryshime konceptuale. (dr7)*

*Rekomandimet janë që të inkuadrohet sa më shumë teknologjia në procesin e mesimdhënies, përmirësimin e organizimit të procesit mesimor që përfshin mënyren se si organizohet puna, mënyrën e raporteve ndërpersonale, mënyra e ofrimit të instruksioneve, dhe përshtatshmeria në pjesët teknologjike. (dr2)*

*Nevoja për avancimin e mëtutjeshëm të mësimin në distancë, duke avancuar mësimin online, dhe ngrirur ndërveprimin në mes të mesimdhënësve, prindërve dhe nxënësve, avancimin e mënyrës së dhënies së instruksioneve për realizimin e detyrave nga nxënësit, dhe sqarimin e metodave të vlerësimit. (dr4)*

*Rekomandimet në kuadër të të cilave përshihen: siguria, kushtet ekonomike, autoriteti, statusi, përgjegjësia, kushtet e punës, niveli i satisfaksionit me veten, apo koha dhe përkushtimi i nevojshëm për të realizuar ndryshimin(dr10)*

## DISKUTIMI DHE KONKLUDIMET

Qëllimi kryesor i këtij punimi ishte zbulimi i perceptimeve të drejtorëve, mësimitdhënësve dhe prindërve mbi organizimin dhe realizimin e mësimit në distancë. Duke u bazuar në literaturë dhe në punime të ndryshme shkencore janë krijuar dy lloje të anketave dhe një pyetësorë të cilat janë aplikuar tek drejtorët, mësimitdhënësit dhe prindërit. Gjithsej në këtë hulumtim kanë marrë pjesë 10 drejtorë, 167 mësimitdhënës dhe 60 prindër. Në përgjithësi janë arritur këto gjetje me profilin e pjesëmarrësve: shumica e pjesëmarrësve mësimitdhënës kanë qenë femra 72,5% ndërsa meshkuj 25,5% dhe shumica nga ta i takonin intervalit të moshës 26-35=26,9% dhe 36-45=37,7% dhe shumica kanë nivel të arsimit baçelor 74,9 % dhe master 19,2%. Pjesëmarrësit prindër shumica kanë qenë femra 88.3% dhe meshkuj 11.7%, të cilët i takonin intervalit të moshës 26-35 =73.3% dhe 36-45 =18.3%, dhe shumica kanë të përfunduar shkollën e mesme 66,7% dhe 30.0 % nivelin baçelor.

Në lidhje me perceptimet e mësimitdhënësve të mostres tonë janë gjetur këto të dhëna:

Mësimitdhënësit e mostrës tonë nuk pajtohen se ju pëlqen ndërveprimi me nxënësit në mënyrë elektronike dhe se pajtohen se integrimi i teknologjisë në mësimin në distancë ishte sfiduese, gjithashtu pajtohen se përparësi e mësimit në distancë është organizimii kohës dhe punës për mësimit, mirëpo nuk pajtohen se mësimit në distancë ka ndikim pozitiv në mbështetjen e të nxënësit te nxënësit.

Mësimitdhënësit pajtohen se kanë pasur vështirësi në qasje dhe përshtatshmëri me paisjet teknologjike për mësimit në distancë, gjithashtu pajtohen se kanë komunikuar rregullisht me nxënësit dhe prindërit e tyre si dhe me drejtuesit e institucioneve në mënyrë që nxënësit të jenë sa më të anagzhuar për mësimit në kushtët e shtëpisë.

Mësimitdhënësit janë pajtuar se kanë dhënë udhëzime në grupin e krijuar për përvetësimin e përmbajtjes mësimitorë ndërmjet mesazheve dhe videove të përgatitura, gjithashtu pajtohen se janë treguar fleksibil në trajtimin e nevojave të nxënësvë gjatë mësimit në distancë.

Mësimitdhënësit nuk pajtohen se mësimit ka qenë efektiv në distancë gjatë periudhës mars-qershor të vitit 2020, dhe mësimitdhënësit nuk pajtohen se nxënësit kanë përvetësuar njohuri të reja.

Është hulumtuar nëse ekziston ndonjë dallim në perceptimet e mësimitdhënësve femra dhe mësimitdhënësve meshkuj sa i përket organizimit të mësimit në distancë.

Meqë organizimi i mësimit në distancë ishte përmbledhur në dy faktorë, efektiviteti i mësimit në distancë dhe angazhimi mësimitdhënës-nxënës, dallimet janë hulumtuar për këta dy faktorë. Sa i përket faktorit të parë, efektiviteti i mësimit në distancë, vlera e testit t ( $F=0,326$ ,  $p>0,05$ ) tregon se nuk ekziston ndonjë dallim i rëndësishëm ndërmjet mësimitdhënësve femra dhe meshkuj.

Sa i përket angazhimit mësimitdhënës-nxënës tregon se ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet mësimitdhënësve femra dhe meshkuj. Mesatarja e mësimitdhënësve femra është 2,073 dhe mesatarja e mësimitdhënësve meshkuj është 2,527. Ky dallim është signifikant dhe tregon se mësimitdhënësit femra janë më shumë të angazhuar me nxënësit se mësimitdhënësit meshkuj. Pra mësimitdhënësit femra pajtohen më shumë me pyetjet të cilat masin angazhimin mësimitdhënës-nxënës sesa mësimitdhënësit meshkuj.

Dallim tjetër me rëndësi në lidhje me këtë faktor ekziston ndërmjet mësimitdhënësve të moshës 26-35 vjeç me ata të moshës më shumë se 46 vjeç. Dallimi mesatar është  $-0,902$  dhe kjo vlerë tregon se mësimitdhënësit e moshës 26-35 vjeç kanë pasur një efektivitet më të ulët të mësimit në distancë se mësimitdhënësit e moshës më shumë se 46 vjeç.

Dallimi i fundit dhe më i vogël në lidhje me këtë faktor është ndërmjet mësimitdhënësve të moshës 36-45 vjeç me ata të moshës më shumë se 46 vjeç. Dallimi mesatar është  $-0,543$ . Ky dallim tregon se mësimitdhënësit e moshës 36-45 vjeç kanë pasur një efektivitet më të ulët të mësimit në distancë në krahasim me mësimitdhënësit e moshës mbi 46 vjeç. Mund të konkludojmë se mësimitdhënësit më të vjetër kanë pasur një efektivitet më të lartë të mësimit në distancë sesa mësimitdhënësit e rinj. Kurse sa i përket faktorit të dytë, dallimi i parë ekziston ndërmjet mësimitdhënësve të moshës nën 25 vjeç me mësimitdhënësit e moshës mbi 46 vjeç. Dallimi mesatar është  $-1,459$  dhe ky dallim tregon se mësimitdhënësit e rinj kanë pasur një angazhim më të ulët me nxënësit e tyre se mësimitdhënësit e vjetër. Dallimi i dytë signifikant ekziston ndërmjet mësimitdhënësit të moshës 26-35 vjeç me mësimitdhënësit e moshës mbi 46 vjeç. Dallimi mesatar është  $-0,959$  dhe ngjashëm sikur mësipër, ky dallim tregon se mësimitdhënësit e moshës 26-35 vjeç kanë pasur një angazhim më të ulët me nxënësit se mësimitdhënësit e moshës mbi 46 vjeç. Pra, përsëri, mësimitdhënësit më të vjetër shihet të jenë më të angazhuar me nxënësit e tyre se mësimitdhënësit më të rinj.

Duke qenë se janë hulumtuar edhe mësimdhënësit të cilët punojnë në fshat, edhe ata në qytet, është hulumtuar nëse ekziston ndonjë dallim ndërmjet tyre në lidhje me organizimin e mësimit në distancë. Ky dallim është testuar me testin-t dhe rezultatet e testit-t tregojnë se nuk ekziston dallim i rëndësishëm statistikor ndërmjet mësimdhënësve sa i përket lokacionit, qoftë fshat apo qytet. Kjo është qartësisht e arsyeshme, sepse përkundër fshatit apo qytetit, mësimit është organizuar në distancë dhe kjo nuk ka penguar që nxënësit e fshatit të jenë më pak efektiv se ata të qytetit.

Mesatarja e mësimdhënësve në fshat për angazhimin mësimdhënës-nxënës është 2,364 dhe mesatarja e mësimdhënësve në qytet për angazhimin mësimdhënës-nxënës është 2,019. Kjo tregon që mësimdhënësit e qytetit kanë një nivel pak më të lartë të angazhimit me nxënësit e tyre se mësimdhënësit e fshatit.

Duke qenë se të gjithë mësimdhënësit e përfshirë në analiza kanë qenë të angazhuar online dhe se të gjithë i kanë parë materialet e transmetuara në kanalin RTK1 ose RTK4, nuk mund të hulumtohet ndonjë dallim ndërmjet mësimdhënësve në këtë aspekt.

Në hulumtimin me prindër, kanë marrë pjesë 60 prindër, 53 prej të cilëve femra dhe 7 meshkuj. 3,3% e prindërve i përkasin moshës më pak se 25 vjeç, 73,3% i përkasin moshës 26-35 vjeç, 18,3% i përkasin moshës 36-45 vjeç dhe vetëm 5% i përkasin moshës më shumë se 46 vjeç. 66,7% e prindërve pjesëmarrës në hulumtim kanë të përfunduar shkollën e mesme, 30% e tyre kanë të përfunduar studimet baçelor dhe 3,3% e tyre kanë të përfunduar nivelin master. 41,7% e prindërve janë të punësuar, kurse 58,3% e tyre janë të papunë. Të gjithë prindërit pjesëmarrës kanë qenë të angazhuar në mësimet online me fëmijët e tyre dhe të gjithë prindërit i kanë shikuar materialet audioviive të transmetuara në kanalin televiziv RTK1 dhe RTK4.

Me anë të këtij hulumtimi kemi arritur në përfundim se angazhimi i nxënësve me mësimin në distancë ndikon 50,5% në efektivitetin e mësimit në distancë, gjithmonë sipas përceptimeve të prindërve gjithashtu sipas hulumtimit nuk ekzistojnë dallime të rëndësishme sipas gjinisë së prindërve sa i përket përceptimeve të tyre në lidhje me organizimin e mësimit në distancë. Me fjalë të tjera, përceptimet e prindërve në lidhje me organizimin e mësimit në distancë nuk ndryshojnë sipas moshës së prindërve. Gjithashtu janë hulumtuar dallimet ndërmjet prindërve sipas nivelit të edukimit ku është testuar me anë të testit Tukey, si testi më i përdorur nga testet post-hoc.

Dallimi mesatar është 1,16250 dhe ky dallim tregon se prindërit me shkollë të mesme kanë një perceptim më të lartë të efektivitetit të mësimit në distancë të fëmijëve të tyre, sesa ata me baçelor. Pra, prindërit me baçelor, mendojnë se efektiviteti i mësimit në distancë nuk është në nivelin e duhur, në krahasim me prindërit me shkollë të mesme.

Nga hulumtimi kemi ardh në përfundim se ekziston dallim ndërmjet prindërve me shkollë të mesme dhe prindërve me nivelin baçelor. Dallimi mesatar është 0,81778 dhe kjo vlerë tregon se prindërit me shkollë të mesme mendojnë se fëmijët e tyre angazhohen mjaftueshëm në mësimin në distancë në krahasim me prindërit me baçelor, të cilët kanë një mesatare negative.

Gjithashtu nga hulumtimi kemi nxjerr ne pah se ekziston një dallim në perceptimet e prindërve në lidhje me organizimin e mësimit në distancë sipas nivelit të edukimit të tyre. Prindërit e punësuar kanë perceptime për efektivitet më të lartë të mësimit në distancë sesa prindërit e papunësuar, mesatarja e të cilëve është duke anuar nga deklarat negative prindërit e punësuar kanë një nivel perceptimi për një angazhim më të lartë të fëmijëve të tyre me mësimin në distancë, sesa prindërit e papunësuar.

Nga nëntë hipoteza të parashtruara në këtë hulumtim kam ardhë në përfundim që disa hipoteza janë pranuar dhe disa jo, duke i argumentuar edhe për rezultatin që kam nxjerrë.

#### **Hipotezat që janë pranuar:**

*H<sub>1</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës ka një efekt të rëndësishëm në mësimin në distancë.*

*H<sub>3</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës dallon sipas gjinisë së mësimdhënësve.*

*H<sub>4</sub>: Efektiviteti i mësimit në distancë dallon sipas moshës së mësimdhënësve.*

*H<sub>5</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës dallon sipas moshës së mësimdhënësve.*

*H<sub>9</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës dallon sipas vendit të punës së mësimdhënësve.*

#### **Hipotezat që janë refuzuar:**

*H<sub>2</sub>: Efektiviteti i mësimit në distancë dallon sipas gjinisë së mësimdhënësve.*

*H<sub>6</sub>: Efektiviteti i mësimit në distancë dallon sipas ciklit të arsimit të mësimdhënësve.*

*H<sub>7</sub>: Angazhimi mësimdhënës-nxënës dallon sipas ciklit të arsimit mësimdhënësve.*

*H<sub>8</sub>: Efektiviteti i mësimit në distancë dallon sipas vendit të punës së mësimdhënësve.*

### ***Kufizimet e studimet***

Gjatë këtij hulumtimi nuk është arritur që të intervistohen një numër më i madh i drejtorëve të shkollave fillore, kjo për shkak të situates pandemike dhe hezitimit të drejtorëve në realizim të intervistës dhe nëse do të kishin marrë pjesë një numër më i madh i drejtorëve hulumtimi do të ishte plotësuar edhe më shumë me mendimet dhe qëndrimet e drejtorëve sa i përketë mësimi në distancë.

### ***Hulumtimet në të ardhmen***

Ky hulumtim, ofron informacione të para të rëndësishme për ata që do të bëjnë hulumtim me vonë me këtë temë në Kosovë. Në hulumtimet e ardhshme mund të mblidhën të dhëna nga një mostër me mësimdhënës dhe prindër të moshuar. Nga ato të dhëna, mund të bëhen krahasime ndërmjetë mësimdhënësve dhe prindër të rinj me mësimdhënës dhe prindër më të moshuar.

### ***Implikimet praktike nga studimi***

Ky hulumtim parashihet të ndihmojë në avancimin e sistemit arsimor të Kosovës, adaptimin e strategjive të arsimit, si dhe organizimin e mëtutjeshëm të mësimi online në mënyrë që mësimi i realizuar të ketë efekte pozitive dhe afatgjata në të gjitha palët e involvuara dhe përfituese të institucioneve edukativo-arsimore. Prandaj, këto të gjetura mund t'u shërbejnë politikëbërësve, udhëheqësve arsimorë, mësimdhënësve edhe prindërve. Për më shumë, nga këto të gjetura dhe implikimet praktike të tyre mund të përfitojnë psikologët e shkollave, të cilët mund të jenë kontribues në mbështetjen emocionale, ngritjen e motivimit, përmirësimin e qëndrimeve ndaj ndryshimeve dhe mbështetjen në avancimin e njohurive e shkathtësive të qëndrueshme nga edukimi nga secila palë përfituese e sistemit të edukimit. Për më shumë, të gjeturat nga ky studim mund të shërbejnë si pikënisje e studimeve të radhës, përmes të cilave mund të ndihmohen sistemet arsimore, në veçanti ato të vendeve me zhvillim të ulët dhe mesatar ekonomik, në kuadër të të cilave hyn edhe Kosova, në tejkalimin e vështirësive në reformimin e sistemeve të edukimit.



## REFERENCAT BIOBLOGRAFIKE

- Akhmetova, D. Z. (2014). *Inclusive Approach to the Psycho-Pedagogical Assistance of Distance Learning*. Kazan: Canadian Center of Science and Education . Retrieved from URL: <http://dx.doi.org/10.5539/ies.v7n11p136>
- Aldahdouh, T. Z. (2020). *Technology and Social Media Usage in Higher Education: The Influence of Individual Innovativeness*. Sage Open.
- Baldwin, S. J., & Trespalacios, J. (2017). *Evaluation Instruments and Good Practices in Online Education*. IES.
- Barinova, Masalimova, A. R., & A., N. (2016). *A Structural and Functional Model of Teachers' Monitoring Skills Development*. Kazan: LOOK ACADEMIC PUBLISHES.
- Benade, F., & Sana, L. (2019). *Constructing a dialogic pedagogy in virtual learning environments: A literature review*. New Zealand: Retrieved from ERIC database.
- Borenko, D. T., Kaisina, D. A., & Fedotova, & D. (2018). *ORGANIZING EDUCATIONAL INSTITUTIONS NETWORKING COOPERATION THROUGH DISTANCE LEARNING TECHNOLOGIES WITHIN REGIONAL EDUCATION SYSTEM*. Pushkin.
- Cacheiro-Gonzalez, D. M., & Medina-Rivilla, D. A. (2020, October). THE LEARNING PLATFORM IN DISTANCE HIGHER EDUCATION: STUDENT'S PERCEPTIONS. *Turkish Online Journal of Distance Education-TOJDE*, pp. 71-72. Retrieved from Turkish Online Journal of Distance Education-TOJDE: <https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ1201882.pdf>
- Cohen, L., Manion, L., & Morrison, K. (2018). *Research Methods in Education*. London & New York: Routledge.
- Donelan, H. (2016). *Social media for professional development and networking opportunities in academia*. Journal of further and higher education.

- Dyson B, V. K. (2015). *Evaluating the use of Facebook to increase student engagement and understanding in lecture-based classes*. Higher education .
- Flamholtz E. G, & R. (2018). *Leading strategic change*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Friedman, L. W., & Friedman, H. (2013). *Using social media technologies to enhance online learning*. Retrieved from ERIC database.
- Given, L. M. (2008). *The Sage Encyclopedia of Qualitative Research Methods*. Los Angeles: Sage.
- Gjoshi R, & K. (2014). Research on the administrator professional training and its role in the implementation of educational institutions reforms in Kosovo. In & K. Gjoshi R, *Research on the administrator professional training and its role in the implementation of educational institutions reforms in Kosovo* (pp. 26-30). Interdisciplinary Journal of Research and Development.
- Gunawardhana, D. L. (2020). *Education Quarterly Reviews*. Sri Lanka: The Asian Institute of Research.
- Huang R.H, L. D. (2020). *Handbook on Facilitating Flexible Learning During Educational Disruption: The chinese Exprience in Maintaining Undisrupted Learning in COVID-19*. Beijing: Smart Learning Institute of Beijing Normal University.
- Huang, R. H. (2020). *Handbook on Facilitating Flexible Learning During Educational Disruption: The Chinese Experience in Maintaining Undisrupted Learning in COVID-19 Outbreak*. Beijing: Smart Learning Institute of Beijing Normal University.
- Ibrahim, A. A.-K.-Z. (2013). *Teacher resisitance to educational change in the United Arab Emirates*. International Journal of Research Studies in Education .
- Kear, K. (2010). *Social presence in online learning communities*. Aalborg, Denmark: In Proceedings of the 7th International Conference on Networked Learning.
- Lurvnik. (2020). *A new world for techers, education's frontline workers*. UNESCO.

- Manca, S. &. (2017). *Exploring digital scholarship: A study on use of social media for scholarly communication among Italian academics. In Research 2.0 and the impact of digital technologies on scholarly inquiry.* IGI Global.
- MASH. (2020). *Udhëzues i përgjithshëm i MASH për organizimin e mësimit në vitin shkollor 2020/2021 në kushtet e pandemisë COVID 19.* Prishtinë: Republika e Kosovës Ministria e Arsimit dhe Shkencës.
- MASHT. (2020). *DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË PËR REALIZIMIN E MËSIMIT NË DISTANCË.* Prishtinë: Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Maxwell, Kelly; Sosinsky, Laura; Tout, Kathryn; Hegseth, Danielle. (2016). *Coordinated Monitoring Systems for Early Care and Education.* Washington.
- NCIRD. (2020). *Coronavirus Diseases 2019. National Center for Immunization and Respiratory Diseases (NCIRD).* Division of Viral Diseases.
- Palvia, S., & Aeron, P. (2018). *Online Education: Worldwide Status, Challenges, Trends, and Implications.* Island: Routledge.
- UNESCO. (2020). *Covid-19 Impact on Education Data. COVID-19 Education Disruption and Response.* Paris, France: The United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization, UNESCO.
- Yokozeiki. (2020). *A new world for teachers, education's frontline workers.* UNESCO.

## SHTOJCA A: PYETËSOR PËR MËSIMDHËNËS

Të nderuar kolegë,

Ju drejtohem me lutje që të shprehni opinionet e Juaja përkitazi me organizimin e mësimit në distancë.

Pyetësi është anonim, prandaj mos hezitoni të ofroni përgjigje, sepse të njëjtat do të më mundësojnë që të hulumtoj më gjerësisht aspekte të rëndësishme të mësimit në distancë, në rrethanat e gjendjes aktuale në të cilat po punojnë institucionet arsimore në Kosovë, ndërkaq për qëllime të tjera ato nuk do të përdoren!

### Paraprakisht Ju falenderoj për bashkëpunimin !

#### I – Të dhënat bio-sociale

**1. Gjinia juaj?**

Femër

  

Mashkull

( Bëni tik √ në katrorin përkatës )

Arsimi i mesëm i lartë

Tjetër

( Bëni tik √ në katrorin përkatës )

**2. Mosha juaj?**

Më pak se 25

26-35

36-45

Më shumë së 46

( Bëni tik √ në katrorin përkatës )

**6. Zona ku ndodhet shkolla ku jep mësim?**

Fshat

Qytet

( Bëni tik √ në katrorin përkatës )

**3. Edukimi juaj?**

Shkolla e mesme

SHLP

Fakulteti

Master

( Bëni tik √ në katrorin përkatës )

**7. A jeni angazhuar ju si mësues/e në mësimet online?**

PO

JO

**4. Pozita juaj?**

Mësimdhënës

Tjetër \_\_\_\_\_

**5. Cikli ku jep mësim?**

Arsimi fillor

Arsimi i mesëm i ulët

**II - Pyetje për përmbajtjen:**

1. A i keni parë materialet audiovizive të transmetuara në programin televiziv “RTK1 ose RTK4”?

PO

JO

( Bëni tik √ në katrorin përkatës )

2. A përdorni me nxënësit tuaj paltforma për komunikimin e përmbajtjeve/temave mësimore?

PO  JO

( Bëni tik √ në katrorin përkatës )

Nese po, atëherë në cilat nga platformat ne vijim:

Viber

Zoom

WhatsApp

Facebook(messenger)

Platforma të tjera

( Bëni tik √ në katrorin përkatës )

3. Deklaratat në vijim lidhen lidhen me perceptimet e Juaja për organizimin e mësimit në distancë.

1-Pajtohem plotësishtë

3-I/e pa përcaktuar

5-Nuk pajtohem fare

2-Pajtohem

4-Nuk pajtohem

( Bëni tik √ në katrorin përkatës )

		1	2	3	4	5
1.	A pajtoheni se ju pëlqen ndërveprimi me nxënësit në formë elektronike.					
2.	A pajtoheni se integrimi i teknologjisë në mësimin në distancë ishte sfiduese.					

3.	A pajtoheni se përparësi e mësimi në distancë është organizimi i kohës dhe i punës për mësim.					
4.	A pajtoheni se mësimi në distancë ka ndikim pozitiv në mbështetjen e të nxënësve tek nxënësit					
5.	A pajtoheni se keni pasur vështirësi në qasje dhe përshtatshmëri në paisjet teknologjike për mësimin në distancë.					
6.	A pajtoheni se komunikoni rregullisht me nxënësit, prindërit e tyre dhe me drejtuesit e institucionit arsimor që nxënësit të jenë të angazhuar për mësimet në kushtet e shtëpisë.					
7.	A pajtoheni se jepni udhëzime në grupin e krijuar, në lidhje me përvetësimin e përmbajtjes mësimore nëpërmjet mesazheve dhe videoeve të përgatitura.					
8.	A pajtoheni se i'u përgjigjini pyetjeve që adresojnë nxënësit në lidhje me përmbajtjen/temat mësimore.					
9.	A pajtoheni se nxënësit kanë vështirësi në qasjen për mësim në distancë.					
10.	A pajtoheni se jeni fleksibil/e në trajtimin e nevojave të nxënësve, gjatë mësimi në kushtet e shtëpisë.					
11.	A pajtoheni se mësimi efektiv mund të zhvillohet edhe pa ndërvepruar me nxënësit ballë për ballë.					
12.	A pajtoheni se mësimi në distancë ka qenë efektiv në periudhën Mars-Qershor të vitit 2020					
13.	A pajtoheni se gjatë mësimi në distancë nxënësit jo vetëm kanë përsëritur njohuritë e fituara më parë, por kanë përvetësuar edhe njohuri të reja.					
14.	Jam i/e kënaqur me angazhimin e nxënësve gjatë procesit të mësimi në distancë					

**Ju falenderoj për bashkëpunimin!**

## SHTOJCA B: PYETËSOR PËR PRINDËR

Të nderuar kolegë,

Ju drejtohem me lutje që të shprehni opinionet e Juaja përkitazi me organizimin e mësimit në distancë.

Pyetëtori është anonim, prandaj mos hezitoni të ofroni përgjigje, sepse të njëjtat do të më mundësojnë që të hulumtoj më gjerësisht aspekte të rëndësishme të mësimit në distancë, në rrethanat e gjendjes aktuale në të cilat po punojnë institucionet arsimore në Kosovë, ndërkaq për qëllime të tjera ato nuk do të përdoren!

**Paraprkishtë Ju falenderoj për bashkëpunimin !**

### I – Të dhënat bio-sociale

**1. Gjinia juaj?**

Femër

Mashkull

( Bëni tik √ në katrorin përkatës )

**4. Statusi i punësimit?**

I punësuar

I papunësuar

Tjetër \_\_\_\_\_

( Bëni tik √ në katrorin përkatës )

**2. Mosha juaj?**

Më pak se 25

26-35

36-45

Më shumë së 46

( Bëni tik √ në katrorin përkatës )

**5. A jeni angazhuar ju si prind në mësime online me fëmijën tuaj?**

PO

JO

**3. Edukimi juaj?**

Shkolla e mesme

SHLP

Fakulteti

Master

( Bëni tik √ në katrorin përkatës )

**6. A i ka parë fëmija juaj materialet audiovizive të transmetuara në programin televiziv “RTK1 ose RTK4”?**

PO

JO

## II - Pyetje për përmbajtjen:

7. Deklaratat në vijim lidhen lidhen me perceptimet e Juaja për organizimin e mësimit në distancë.

1-Pajtohem plotësishtë

3-I/e pa përcaktuar

5-Nuk pajtohem fare

2-Pajtohem

4-Nuk pajtohem

( Bëni tik  $\checkmark$  në katrorin përkatës )

		1	2	3	4	5
1.	A pajtoheni se ju si prind e mbështetni fëmijun në mësimin në kushtet e shtëpisë.					
2.	A pajtoheni se të mësuarit në distancë ka të njëjtën cilësi si procesi mësimor në klasë.					
3.	A pajtoheni se fëmija juaj angazhohet maksimalisht për kryerjen e detyrave të dhëna nga mësuesit e tij.					
4.	A pajtoheni se fëmija juaj mund të bëjë pyetje për mësuesin e tij dhe të marrë një përgjigje të shpejtë gjatë aktiviteteve mësimore.					
5.	A pajtoheni se fëmija juaj jo vetëm që ka përsëritur njohuritë e fituara më parë, por edhe ka përvetësuar njohuri të reja.					
6.	A pajtoheni se gjatë mësimit në distancë, fëmija juaj merr vlerësime ose komente nga mësuesit për detyrat ose ushtrimet që kryen.					
7.	A pajtoheni se mësimi efektiv mund të zhvillohet edhe pa ndërvepruar mësuesi me nxënësit ballë për ballë.					
8.	A pajtoheni se të mësuarit në mënyrë elektronike ndikon në zhvillimin personal dhe social të fëmijës tim.					
9.	A pajtoheni se fëmija juaj punon në grup gjatë aktiviteteve të mësimit online.					

**Ju falenderoj për bashkëpunimin!**



## **SHTOJCA C: PROTOKOL I INTERVISTIMIT**

- 1.A mund të më tregoni pak për veten tuaj;Sa vite përvojë keni? Vendi i punës? Cili është kualifikimi i Juaj?
- 2.Sa keni qenë të angazhuar ju si drejtor të përcjellni ecurinë e procesit të mësimit në distancë?
  - a) A jeni të kënaqur me punën dhe angazhimin e mësimeve në procesin e mësimit në distancë?
  - b)A bashkëpunoni me mësuesit për procesin e organizimit të mësimit në distancë?
  - c) Sa i motivoni ata për punën e tyre?
- 3.Cilët janë disa nga faktorët që ndihmojnë organizimin e mësimit në distancë?
4. Cilët janë disa nga faktorët që pengojnë organizimin e mësimit në distancë?
- 5.Numëro disa sfidat që ndërlidhen me mësimin në distancë,dhe pse i konsideroni si sfidë?
6. Cilat janë rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së organizimit të mësimit në distancë ?

**Ju faleminderit për bashkëpunim!**